

Kuvendi

Qarku Elbasan

Arbjan Mazniku

Të nderuar miq, të nderuar anëtarë të komisionit, së pari ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj. Fillojmë sot një seri të re dëgjimesh, siç është dhe e kërcuar përpara në agjendën e punës së komisionit. Këto janë dëgjime me kryetarët e bashkive. Kemi vendosur bashkërisht që këto dëgjime të bëhen në nivel qarku, dhe të kemi të gjithë kryetarët e bashkisë të një qarku, dhe të kemi mundësi të bëjmë një bisedim të hapur për të gjitha ato tema që deri tashmë janë bërë tema diskutimi të reformës administrative territoriale. Kërkesa e përgjithshme është që të fokusohemi me radhë te ato tre tema kryesore, si tre kategori temash, secila prej tyre ka një mori nën-temash sigurisht, gjëra që kanë të bëjnë me kompetencat e bashkive, me funksionet, me mundësitë që bashkitë kanë për t'i ushtruar funksionet e tyre, me qofshin këto mundësi ligjore, pra a është qartësisht e strukturuar në ligj mënyra se si duhet ushtruar një funksion i caktuar, a ka mangësi, a ka probleme, a ka gjëra që duhen bërë më mirë, a ka funksione që ushtrohen dot, a ka funksione që s'ushtrohen dot. Është kategoria e parë që lidhet me funksionet. Kategoria e dytë lidhet me financat, si është situata financiare, kush janë problematikat, kush janë çështjet që lidhen me të ardhurat që mbledhin vetë bashkitë, çështjet që kanë të bëjnë me grantin ndërqeveritar, ato që janë paratë që vijnë nga qeveria qendrore, qofshin nëpërmjet grantit të pakushtuar, qoftë në programet sektoriale, çfarë funksionon, çfarë s'funksionon mirë, çfarë mund të funksionojë më mirë, dhe sigurisht ajo që është tema që tërheq edhe më shumë vëmendje, që ka të bëjë me elementin e territorit dhe qeverisjes, sigurisht të bindur dhe të qartë që kryetarët kanë një pozicion të kryetarit, përfaqësojnë njerëzit e komunitetit respektiv, përfaqësojnë qytetin, përfaqësojnë një histori të caktuar pune dhe funksioni. Unë kam një kërkesë të përbashkët që, ashtu siç tashmë për fat të mirë është bërë një traditë e shëndetshme e këtij komisioni, të bëjmë një proces të qëndrueshëm, ku të kemi mundësi që secili nga anëtarët të bëjë pyetjen apo pyetjet që ka, dhe t'i japim mundësinë kryetarëve që të përgjigjen në mënyrën që e gjykojnë dhe t'i japin secilit përgjigjen e tyre, në mënyrë që të kemi mundësi të mbledhim dhe të kuptojmë çfarë janë gjërat që mund të përmirësojmë apo duhet të përmirësojmë. Kemi gjithashtu prezent një pjesë të madhe të ekspertëve, të propozuar nga të gjitha palët që janë pjesë e komisionit, në mënyrë që përveç elementit politik nga anëtarët e komisionit, të kemi dhe element teknik nga ekspertët që do të vlerësojnë më pas se çfarë duhet dhe si duhet të bëhet. Unë mendoj që kjo është një fazë shumë e rëndësishme e procesit, pasi teksa padyshim dëgjimet që jemi duke bërë në mënyrë të vazhdueshme me qytetarët e të gjithë qarqeve kanë një vlerë të jashtëzakonshme dhe të dobishme, pasi e shohin çështjen e qeverisjes vendore nga ana e përfituesve, nga ana e qytetarëve, nga ana e komunitetit, është e rëndësishme ta shohim nga ana e njerëzve të cilët e kanë mbi shpatulla barrën për të administruar territorin, kanë mbi shpatulla barrën për të ushtruar një funksion të caktuar, për të bërë bashkë njerëzit në një institucion që ta bëjnë, për të siguruar financat dhe për t'u siguruar që kjo pjesë e punës të funksionojë. Ndaj, me bindjen që nga ju do marrim një opinion të njeriut që e ka këtë barrë mbi shpatulla, jam shumë i interesuar të dëgjoj të gjithë pjesën tjetër të diskutimit. Gjatë ditës së sotshme, në fakt, mbledhja do të bëhet me tre momente. Do kemi Elbasanin, pastaj do kemi Durrësin dhe eventualisht Kuksin, pra kemi tre qarqe të cilat do t'i dëgjojmë të gjithë sot. Elbasani është qarku më i madh. Nuk

jemi sot prezent për arsye objektive të mosqenurit në Shqipëri. Kryetari i Bashkisë së Elbasanit dhe Kryetari i Bashkisë së Gramshit na kanë shkruar dhe janë jashtë Shqipërisë në një udhëtim të parashikuar prej shumë kohësh, por u gjykua që duhet të vijojmë përpara me këtë fazë dëgjimesh dhe nëse do të gjendet një moment tjetër më pas, do të shohim mundësinë për t'i akomoduar në një dëgjim. Po ecim përpara me dëgjimet sepse është një ushtrim i cili bëhet shumë i vështirë nga ana teknike për t'u koordinuar agjendat e të gjithë njerëzve, kështu që ishte më e mirë e udhës që të ecim përpara. Mendoj që nëse i qëndrojmë këtyre parimeve, do të kemi një dëgjim të frytshëm jo vetëm për ne, por edhe për publikun që na ndjek. Faleminderit!

Luciano Boci

Të nderuar deputetë anëtarë të komisionit, të nderuar të ftuar, kryetarë të bashkive të qarkut Elbasan, komisioni ka vendosur të bëjë dëgjime me ju si përfaqësues, sepse në konceptin tonë ju jeni elementi themelor dhe i pushtetit vendor krahas qytetarit. Ndërsa qytetari është marrësi i shërbimit, sigurisht ju jeni dhënësit e shërbimit nëpërmjet atyre kanaleve që ne i gjykojmë që janë apo nuk janë efektive. Dëgjimet me qytetarët kanë nxjerrë një sërë problemesh që lidhen edhe me përfaqësimin, edhe me shërbimin, edhe me autonominë financiare që ju përket juve, dhe me funksionalitetin, dhe me kompetencat, dhe me autonominë tuaj që në fakt duhet prekur nga ju, dhe me demokracinë e pushtetit vendor që është një nga kriteret kryesore të Bashkimit Europian, meqënëse jemi në një proces të përgatitjes së Shqipërisë për t'u futur në BE, por që nuk përbën ndonjë kusht kryesor dhe themelor, siç është munduar të transmetohet disa herë si kërkesë nga BE-ja për të qenë ne pjesë e Bashkimit Europian. Pushteti lokal ka disa forma, mënyra të organizimit të tij, të shprehë funksioneve, kompetencave dhe të autonomisë, dhe ndryshon sipas vendeve të ndryshme. Patjetër që ne duam të gjejmë atë përbashkësinë më të mirë të funksionalitetit të pushtetit vendor në raport me qytetarin, dhe unë do të doja që ju të keni ardhur këtu duke konsideruar dhe çështjet e shumta që kanë ngritur qytetarët në dëgjimet e tyre, aq më tepër që me Elbasanin ne e kemi kryer këtë dëgjim. Ju keni qenë prezent, keni dëgjuar opinionet e tyre në raport me largësinë e shërbimeve, në raport me mungesën e përfaqësimit, në raport me cilësinë e shërbimeve, në raport me pasojat që ka dhënë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së tyre, mënyra se si i ofrohet shërbimi nga pushteti vendor. Pasoja më e dukshme është shpopullimi i Elbasanit, meqënëse jemi te Elbasani, por dhe i Shqipërisë. Këtij shpopullimi i është shtuar dhe një alarm tjetër, një raport që ka dalë për lindshmërinë natyrore në Shqipëri, që është në negativitet për herë të parë në një tremujor, dhe kjo gjë përfshin dhe Elbasanin, një tregues i qartë që vjen nga INSTAT, në fakt, si raport që dëshmon që shpopullimi i Shqipërisë nuk është një lëvizje migratore. Ka lëvizje migratore në një përqindje jo ndikuese, por është lëvizje e migratore, dhe për këtë, domethënë, një përgjegjësi e madhe i përket pushtetit vendor, si i qaset ai funksioneve të tij dhe shërbimeve që ai ofron. Patjetër që është edhe përgjegjësi e qeverisjes qendrore, dhe dikush mund të thoshte edhe politikës. Po, po e pranojmë dhe këtë pjesën tjetër, por pjesën kryesore të përgjegjësisë e ka ai që qeveris, sepse ai është edhe shkaktari i pasojës. Ne vlerësojmë shumë praninë tuaj këtu. Duam t'ju dëgjojmë larg subjektivizmave, larg politikës. Është paksa e vështirë në Shqipëri, sepse ne e dimë shumë mirë, jemi njerëz që vijmë nga terreni. Ne e dimë angazhimin tuaj politik të kërkuar nga qendra se çfarë bëhet me pushtetin lokal përgjatë proceseve zgjedhore në Shqipëri, se si shërbimi ndaj qytetarit shndërrohet shërbim ndaj votës dhe jo ndaj qytetarit. Por e rëndësishme është t'ju dëgjojmë juve. Në raport me këtë mënyrë sjellje, është një sjellje politike që është vënë dukje, dhe në dëgjime është vënë dukje edhe nga ne si politikanë. Është një element shumë i rëndësishëm që dëmton qeverisjen vendore, të cilën jo të gjithë në përqindje e keni ju në dorë, por secili nga ju me personalitetin e vet mund të shkëputet

nga kjo mënyrë e bërjes së politikës në Shqipëri. Dhe ajo që dua njëkohësisht është që parashtrimet tuaja të jenë sinqerta. Sot jemi përballë dy kërkesave dhe s'duhet të fshihemi. Ka një kërkesë nga Partia Socialiste për konsolidim administrativ të mëtëjshëm pas konsolidimit të 2014-s, çka presupozon një ulje të numrit të bashkive, çka presupozon në një kontekst që bashkitë e mëdha ose bashkia e madhe të përthithë bashkitë e vogla. Keni rastin që të shprehni mendimin tuaj pranues apo kundërshtues me argumente për këtë gjë, jo duke konsideruar që rrezikoni pozicionet tuaja, por duke konsideruar që rrezikoni shërbimin ndaj qytetarit, sepse sikurse qytetari e ka plumbin lëkurë dhe e di shumë mirë cilësinë e shërbimit, në një farë forme dhe mënyre, dhe ju e dini shumë mirë se si i ofroni shërbimet, se si arrini atë qytetarin fundor, se si arrini qytetarin e afërt, se si i përqendroni investimet diku më shumë, sidomos në qendër apo diku më larg, se si i shpërndani në kohë para fushatave, suleni në aksion total investues dhe përgjatë gjithë kohës rrini në pauzë, dhe se si bëni dhe diferenca politike. Diku në një lagje që është djathtas nuk ikën investimi, në një fshat që është djathtas nuk shkon investimi apo shërbimi, sepse thelbi është bërja e një lufte politike rigjide. Ndërkohë, ka një problem me metodologjinë e ngritjes së kësaj dëgjimi. Anëtarët tanë të grupit të ekspertëve kanë kërkuar prej kohësh të dhëna nga qeverisja qendrore për pushtetin vendor, për ato pika që i kanë gjykuar të domosdoshme për të ngritur edhe arsyetimet, pyetjet dhe komunikimin dhe dëgjimet midis nesh. Ndonëse ka gati një muaj që janë kërkuar, këto dhëna nuk janë sjellë. Ka pasur pengesa subjektive, mund të jenë dhe objektive, por sot duhet të jeni të ndërgjegjshëm që dhënat që referojnë anëtarët tanë të komisionit, por edhe dhënat që vijnë nga ekspertët, janë deri në vitin 2022. E thashë këtë sepse asnjëri prej jush nuk mund të ballafaqojë dhe të atakojë shifrat që do parashtrohen këtu. Dhënat që janë marrë nga ne janë dhëna publike. Pra, këtu mungon transparenca nga institucionet qendrore, sikurse edhe nga ana juaj. Në faqet tuaja të uebit duhet të keni të dhëna të përditësuara, me qëllim që këto dhëna të ishin në disponim edhe të ekspertëve tanë. Këto dhëna nuk janë, kështu që konsiderojeni dhe këtë gjë në dëgjim. Ndërkohë, që insistojmë në shpejtësinë e ardhjes së dhënave, sepse një gjë e tillë pengon edhe punën e përbashkët të ekspertëve për të avancuar në ato detyra që i janë përcaktuar grupit të ekspertëve. Faleminderit. Vijoje më me dëgjimin. Po, zoti Mziu.

Xhelal Mziu

Të nderuar bashkëkretarë, të nderuar kolegë, mënyra se si po funksionon komisioni, jam absolutisht skeptik me rezultatin që do merret. Po bëjmë një periudhë jo të vogël që ne nuk mblidhemi si komision. Kemi rënë në një rreth vicioz, për shkak edhe të kurthit të përgatitur, nëse do ta quaj, janë nga mazhoranca. Nuk kam parë ndonjë komision që punon në emigrim dhe nuk punon në strukturën e komisionit ose në debat me shtresa të cilat janë vulnerabël në këtë drejtim. Komisioni, në këndvështrimin tim, është futur në një rreth vicioz. Po bëjmë tur takimesh nëpër qendrat e qarkut që janë totalisht e kundërta e asaj çfarë kërkojmë. Pra, po bëjmë një centralizim duke shkuar nëpër qendrat e qarqeve, që çdo kryetar bashkie do të kërkonte që e gjithë qarku ta kishte bashki. Së dyti, po prapë fillojmë një tur duke u përsëritur, po themi, me këto qendra qarqesh për t'i ftuar në këtë takim. Unë dua të sjell në vëmendje dy gjëra të cilat, në fakt, kanë ardhur si rezultat i qasjes së ndryshme midis komisionit. Kemi një strukturë bashkish jo të pakta, janë rreth më shumë sesa 20 apo 25 bashki, të cilat na komunikojnë për të mos i shkrirë, duke ju referuar, po themi, edhe nga pronësimet e mazhorancës, duke filluar, po themi, që nga Këlcyra, apo Memalia, apo Poliçani, apo Kuçova, apo Roskoveci, apo Klosi, apo Bulqiza, apo Hasi, apo Vau i Denjës, apo Fusharzi, e mjaft bashki të tjera të cilat kërkojnë që nisma e Partisë Socialiste për të reduktuar numrin e tyre është e pavend dhe ato kërkojnë me patjetër të jenë pjesë e këtij diskutimi, duke shkuar komisioni atje, apo dhe duke i ftuar ato

për të ardhur këtu. Po, do të ishte më normale për të shkuar në këto bashki. Së dyti, kemi një tjetër kontingjent ish-njësish vendore, të cilat kërkojnë për të qenë bashki, sepse decentralizimi është kauzë jo e Shqipërisë, por është një kauzë e vendeve të Bashkimit Europian dhe ka një numër të konsiderueshëm, madje një pjesë e konsideruar e këtyre kërkesave, të cilat janë diku te 40 njësi vendore, të cilat kërkojnë nga bashkimi, apo edhe duke qenë të vetme, për të qenë, po themi, njësi e re dhe kërkojnë me patjetër që të organizohen takimet, duke filluar, po themi, që nga Velipoja, apo duke vazhduar me Shëngjinin, apo me Rubikun, apo me Milotin, apo me Mamurrosin, apo me Kastriotin, apo me Maqellarën, apo me Sukthin, apo të tjera, të cilat unë nuk po i përmend, por që numri i tyre është diku te rreth 40 nga këto hotspote ose zona, të cilat kërkojnë diskutim për të komunikuar dhe në këtë kontekst kërkojnë nga ju, duke ju kërkuar ndjesë, përfaqësuesit e Elbasanit, kur do të fillojë një punë efiçente komisioni për t'u marrë me këtë çështje. Së dyti, kemi kërkuar informacione shtesë, të cilat duhet të na vinin nga strukturat edhe qendrore dhe ato lokale. Asnjë informacion nuk kemi, ndërkohë që komisioni i posaçëm ka një procedurë dhe më të përsheptuar sesa kur një deputet i drejtohet për të marrë shkresa dhe akoma nuk kemi marrë shkresë. Ndërkohë, po prapë ka qenë kryet herës që do të shihnim eksperiencën e dy vendeve, ç'na duhet, edhe nëse do të shkonim në finale për të shkuar diku tjetër për të parë se si funksionon, po themi, pushteti vendor, se si janë referencat krahasuar me Shqipërinë dhe po prapë nuk e bëjmë. Edhe për të shkuar përtej kësaj, në dallim nga ajo se çfarë trumbeton mazniku, zoti, çfarë trumbeton mazniku kur del në studio, apo dhe këtu që na konsideron histori suksesi kur ka centralizim, po marr vetëm rastin e qarkut të Elbasanit nga shtatë njësi vendore. Për çudi ndodh që tre njësi vendore me popullsi më të ulët kanë një rentabilitet më të lartë, duke filluar me Prenjasin, duke vazhduar me Gramshin dhe duke shkuar me Librazhdin. Pra, mjafton ky indikator për të treguar se kush është qasja dhe po prapë ne s'kemi nevojë për të shpikur rrotën. Ne duhet të shkojmë drejt standardeve të Bashkimit Europian, që ka një mesatare diku te 6,000 banorë për njësi vendore dhe ne kemi mesataren 70,000 dhe kjo ka sjellë për pasojë që Shqipëria të zbrazet, që bujqësia të rrënohet, që arsimit dhe shëndetësia t'i mbyllë pafundësisht në të gjithë zonat rurale institucionet e tyre dhe të kemi një situatë në të cilën Shqipërinë e ka bërë, po themi, edhe me moshën mesatare më të vjetër, apo që vdekjet janë më shumë sesa lindja. Jo pak rol në këtë drejtim ka dhe decentralizimi dhe jo centralizimi që po kërkon mazhoranca. Kështu që në këtë kontekst do të kërkonja që ne të ndryshojmë axhendën dhe të marrim në konsideratë këto grupe vulnerabël të cilët kërkojnë ne si anëtarë komisioni për të gjetur një zgjidhje dhe për të marrë mendimin e tyre. Të faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Atëherë, për të pasur mundësi që të jap dy-tre përgjigje deputetit të nderuar. Së pari, për sa i përket çështjes së punës së komisionit, kemi debatuar bashkërisht në komision për një axhendë pune për të cilën jemi dakordësuar të gjithë bashkë dhe për fat të mirë, unë besoj që axhendën e punës që dakordësuam me hapat e dëgjimeve në territor dhe me thirrjen e kryetarëve këtu për dëgjime, jemi duke e ndjekur në mënyrë të qëndrueshme dhe kjo merr sot që flasim neve tre ditë nga të plotat, pothuajse nga pesë ditë të javës. Të martën dhe të premten ne kemi dëgjime në territor, të mërkurën kemi pothuajse një ditë të plotë me dëgjime me kryetarët. Kjo do të thotë nga ana e axhendës, kemi një axhendë të dakordësuar të gjithë punës dhe po e ndjekim në mënyrë sistematike. Nëse ka propozime për amendimet e axhendës, na i sillni këto propozime praktike, pra jo thjesht në një mendim se çfarë duhet të bëhet tjetër, po themi të bëjmë këtë gjë në ditën e hënë, të ndërrojmë këtë me këtë, ditën e mërkurë para ditës të bëjmë këtë dhe këtë. Pra, unë jam shumë i gatshëm që të shqyrtojmë në mënyrë të prekshme dhe të drejtpërdrejtë çdo

amendim të mundshëm i cili i shkon në dobi funksionit të punës dhe identifikimit të zgjidhjeve më të mira të mundshme për njerëzit. Për sa i përket pikës së dytë të informacioneve, i kam kërkuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjithë ekspertëve dhe ekspertëve të propozuar nga opozita, por dhe atyre të propozuar nga mazhoranca, që të na sjellin një listë specifike me informacionin që kërkojnë, me institucionin nga ku duhet të vijë ai informacion, në mënyrë që ne t'i çojmë një kërkesë formale të bashkëpërmoshuar nga bashkëkryetarët, por të qartë t'i themi Ministrisë së Financave: "Duam këtë informacion", t'i themi Zyrës së Tatimeve: "Duam këtë informacion", t'i themi Instatit: "Duam këtë informacion", se nëse i themi një institucioni: "Na çoni", se një ndër kërkesat që mora ishte: "Të gjithë informacionin që keni ju për bashkitë". Do marrim një përgjigje të pjesshme dhe pastaj do të thuhet pse s'na erdhi informacioni. Zgjidhja më e mirë është të na thuhet: "Duam të ardhurat e bizneseve, duam numrin e bizneseve, duam xhiron, duam numrin e popullsisë" dhe t'i kërkojmë institucionit respektiv informacionin që ai institucion ka detyrë ta mbledhë. Po, një ndër kërkesat që do të diskutuam, i kërkohej bashkisë numri i banorëve. Numrin e banorëve të bashkisë e ka Instati ose e ka Gjendja Civile. Janë dy institucione qendrore që kanë numrin e banorëve. Instati ka numrin e banorëve sipas censusit, Gjendja Civile ka numrin e banorëve sipas listës dhe ja kërkojmë atyre që e kanë që të na e japin, se bashkitë do ta kërkojnë dhe ata diku që të na e sjellin. Numrin e bizneseve, sa biznese ka në qytetin tuaj, ishte një ndër pyetjet. Këtë kërkesë do ia çojmë prapë Zyrës së Tatimeve, se e ka Zyra e Tatimeve në mënyrë funksionale, se bashkitë e kanë të pjesshme, se e kanë të plotë si informacion, sepse ka një seri biznesesh të cilat nuk janë të regjistruara tek tatimi dhe bashkitë vetë i marrin nga tatimet numrin e bizneseve të regjistruara. Kjo do të thotë, duke e pasur listën e mirëfilltë të informacionit, dhe kjo nuk është një gjë që është njëherë, mund ta bëjmë sa herë duam, çdo ditë na duhet një informacion i ri, na përcjell një kërkesë, ja përcjell institucionit respektiv dhe unë do të sigurohem që, përveç pjesës t'i çojmë letrën, t'i bimë dhe mbrapa me telefona dhe me kërkesë që informacionet të na vijnë në kohë dhe të na vijnë shpejt. Por, hapi i parë ku ka ngelur gjëja është pasja e një liste të qartë kërkesash për informacion dhe specifike, pra jo thjesht gjenerike. Na duhet ky informacion, ky informacion, ky informacion dhe unë ju siguroj që do ta përcjellim këtë me shpejtësinë maksimale të mundshme. Unë mendoj dhe kjo është pika e fundit që kisha, është që nëse i kapërcejmë fazat e diskutimit dhe fillojmë që tani diskutimin për çfarë do të ndodhi me Këlcyrën apo çfarë do të ndodhi me Cakrën, kalojmë një fazë të rëndësishme. Faza e parë që kemi rënë dakord është: dëgjojmë njerëzit në dëgjime, paralel me këtë po dëgjojmë kryetarët e bashkive, të krijojmë një ide për standardet të prekshme, për parimet, për çështje ekonomike, për çështje burim njerëzore, për çështje kapaciteti për t'i ushtruar financat dhe patjetër do kemi gjithë kohën e duhur për të diskutuar çfarë do bëjmë. Ne nuk mund të shkojmë të bëjmë një dëgjim me një komunitet të caktuar të një bashkie, të bazuar në thashetheme, që kjo do bëhet kështu, ajo do bëhet ashtu, se do do i japim ne zë më shumë një thashethemi që është ngritur me qëllim politik apo pa qëllim politik, ç'rëndësi ka për çfarë është ngritur. Po, sot që flasim ne, komisioni dhe mazhoranca në komision nuk ka asnjë pozicion as për një bashki, as për ndonjë ish-komunë. Sot duhet të krijojmë një proces dhe besimi që duhet të kemi është ky: nëse krijojmë një proces të qëndrueshëm bashkërisht, krijojmë ca standarde, vlerësojmë një seri problemesh reale, nisemi nga qëllimi i mirë për t'i zgjidhur problem qeverisje-qytetarëve, në fund do identifikojmë një zgjidhje të qëndrueshme. Padyshim në këtë çështje, se nuk është çështje që duhet të... padyshim në këtë çështje vijmë nga dy pozicione të kifta. Opozita e ka shprehur qartësisht pozicionin e vet që thotë: "Ne mendojmë që duhen më shumë bashki", mazhoranca ka thënë që: "Ne mendojmë që konsolidimi ka funksionuar dhe duhet të funksionojë". Por, nëse ka pikëprerje mes tyre dhe si do dhe ku takohen këto, është një çështje që do ta gjejmë rrugës. Le të bëjmë hapat e procesit dhe të mbledhim produktin e

procesit. Sot jemi në një fazë që kemi tre qarqe për të dëgjuar kryetarët e bashkive, dëgjojmë kryetarët e bashkive se ndoshta na thonë një gjë që na volit për të vlerësuar qoftë pozicionin tonë, qoftë pozicionin tuaj. Ta mbledhim, kemi ekspertë që do ta mbledhin në mënyrë profesionale dhe analitike të gjithë të dhënat që kemi dhe do kalojmë secilin hap. Ky është mendimi im, por sërish në mbyllje të kësaj faze diskutimi, unë besoj që jam shumë i gatshëm që të vlerësojmë çdo kërkesë të mundshme për ndryshime të axhendës së dakordësuar dhe të miratuar dhe ta vlerësojmë. Nëse është një gjë që i bën mirë punës, patjetër ta miratojmë. Nëse është një gjë që s'bijem dakord, të ndjekim axhendën për të cilën kemi rënë dakord deri tani, por ta vlerësojmë në mënyrë praktike dhe të prekshme.

Luciano Boci:

Unë i bashkohem shqetësimeve të zotit Mziu. Ka një fragmentarizim të punës së komisionit, sepse është përqendruar më shumë në pjesën e dëgjimeve dhe është larguar nga takimet klasike që një komision, në këtë rast i reformës, duhet të bëjë dhe duhet të diskutojë ecurinë dhe shumë gjëra tjera, sepse këtu tani sapo dëgjova që konkluzioni qënka që konsolidimi paska funksionuar. Së pari, ne duhet të marrim një raport vlerësimi nga ekspertët, i përcaktuar edhe nga pranimi i punës së komisionit dhe ky raport vlerësimi është raport profesionistësh dhe në bazën e këtij raporti dhe në bazën e dëgjimeve, ne mund të themi që ka funksionuar mirë apo ka funksionuar keq, sepse në qoftë se do të kishte funksionuar kaq mirë, atëherë ky komision bie, rrëzohet, nuk duhet të ekzistojë dhe të vazhdojë punën e tij. Në qoftë se e kemi shumë mirë, pse duhet ta bëjmë gjithë këtë demarsh, gjithë këtë ndërmarrje për të ndërtuar një reformë tjetër territoriale? Pra, mos dalim në përfundime të paracaktuara, se duken të paracaktuara politikisht. Komisioni, një ndër misionet që ka, është për të përcaktuar këtë gjë: që ishte i suksesshëm apo jo, duhet korrigjuar apo jo. Ne ende pa nisur mirë, ne dalim në përfundimin që paska qenë shumë i mirë dhe për më tepër, kërkesa jonë nuk është kërkesë që kërkon të godasë konsolidimin, sepse ne po themi të shtojmë në mënyrë optimale numrin e bashkive. Nuk ka një kërkesë të kthimit tek 373-shi. Ta bëjmë shumë qartë dhe suksesi matet me pritshmëritë, e kam thënë edhe në dëgjime, me pritshmëritë që ndërtoi reforma e 2014-s, jo me para 2014-s, sepse ka një konsensus të pranuar në opinion që po, 373 ishin shumë, por sikurse ka një mendim të përbashkët në opinion që 61 janë shumë pak dhe ne s'mund të përdorim të njëjtën rrugë, sepse sot ne gjendemi përballë kërkesës së qytetarit për shërbime, për përfaqësim, për demokratizim të pushtetit vendor dhe kjo nuk është rastësi, nuk është e ardhur thjesht nga politika, por vjen bruto nga qytetari dhe ne patjetër që duhet të kalojmë në dëgjime me komunitetet. Metodologji e kemi përcaktuar që po të dëgjojmë qarqet edhe me dëgjime nga publiku, të vazhdojmë ndoshta këtu do kërkohej debat me dëgjime tematike, me dëgjime të kryetarëve të bashkive dhe të kalohet pastaj me dëgjime nga komunitetet. Unë do mendoja që ne të kalojmë direkt pas dëgjimeve që organizojmë në qarqe, paralelisht me kryetarët e bashkive, të kalojmë direkt në dëgjime të komuniteteve. Ka shumë kërkesa, kërkesa që janë transmetuar edhe në takimet tona, por dhe kërkesa që kanë ardhur nëpërmjet rrugëve të tjera zyrtare. Pra, të jemi shumë të qartë në atë çfarë po ndodh, jo se të bëjmë sikur s'ka ndodhur asgjë dhe të vazhdohet në atë vendim të paracaktuar dhe thjesht ta mbushim qëllimin dhe vendimin me një show politik, show dëgjimesh, që në fund ne morëm mendimin e përbashkët, por mendimi i përbashkët na rezultoi si mendimi i paracaktuar që qenë kemi shumë mirë, madje të avancojmë nga 61 t'i bëjmë akoma më pak, ta ulim numrin, sepse vetëm kështu mund të arrihet suksesi, ndërkohë që ajo drejt, po e them kështu me pozitivitet, Europe, së cilës i referohemi, nuk e ka fare tendencë një gjë të tillë, ka tendencë që të çojë shërbimin tek qytetari i fundor, ka përcaktuar disa parametra, 6000 banorë mesatarisht për njësinë vendore, ne e kemi 40000, ka përcaktuar dhe kohën e arritjes së shërbimit, 60 minuta, ka përcaktuar dhe

mënyrën si mbështeten financiarisht, diku nëpërmjet menaxhimit të taksave nga vetë pushteti vendor, diku nëpërmjet buxhetit të shtetit, me një mbështetje që qeveria duhet t'ia japë pushtetit vendor apo formave të alternuara dhe për të shëndoshur punën që ka komisioni. Ajo që pengon punën e komisionit, që unë e kam shprehur si shqetësim dhe po e ngre prapë, është vendosja e një kufiri të përfundimit të punës së komisionit. Po, është e vërtetë që ka intensitet, bëjmë dy dëgjime në javë, një dëgjim me kryetarët e bashkive, tre ditë të javës janë ngarkuara me punën e komisionit, ndërkohë që nga të gjithë ekspertët, nga të gjithë përfaqësuesit ndërkombëtarë, në të gjitha takimet, ajo që është atakuar ka qenë koha e ngushtë për të bërë një reformë. Po bëjmë reformë apo po bëjmë një show reformë? Që të bëjmë reformë, reforma do kohë, nuk ka kompleks PD-ja, pse mbaron herët apo pse mbaron vonë? Jo, ka kërkesën që çdo gjë të jetë objektive, çdo gjë të jetë e konsultuar edhe puna e ekspertëve të jetë e tillë, e shtrirë dhe në kohë, por dhe në qëllime, një punë profesionale, mbas të dhënave që duan, mbas kohës që çdo punë e kërkon dhe pa pasur asnjë lloj qëllimi që ju e interpretoni sabotues. Nuk, opozita e ka dëshmuar qartazi, ka qëndrimin e vet, kërkon optimizim, se nuk e kërkon PD-ja, mos e transmetojmë kështu, e kërkojnë qytetarët, i kemi dëgjuar vetë, madje unë e di shumë mirë që secili prej kryetarëve të bashkive, pa e intimiduar fare, mendojnë që bashkitë e tyre nuk mund të shkrihen me bashki të tjera, nuk mund të shkrihen, sepse kanë identitet territorial, ekonomik, shpirtëror, historik dhe është krejt e pamundur në logjikën e tyre, sepse dhe një pjesë e madhe e tyre vijnë nga terreni dhe e dinë këtë lloj konstitucioni që ata marrin në takimet e tyre me qytetarët. Sigurisht nuk e kanë të lehtë ta shprehin, nuk e kanë të lehtë, por ta bëjmë ne, por duhet ta bëjmë dhe ne dhe qytetarët që e kanë bërë. A mund të shtojmë në Elbasan ne? Sepse kemi kryetarin e bashkisë, Elbasanin, këtu. Patjetër që mund të shtojmë, Elbasani është tërërisht, ka një lloj pamje shumë kontradiktore brenda bashkisë vetë, ka Zavalinën e largët, ka pjesën e qytetit që kanë natyra krejt të ndryshme të zhvillimit të tyre ekonomik apo edhe të vazhdimësisë së unitetit të territorit dhe të vazhdimësive të tjera. Pra, unë bashkohem me Xhelalin për pjesën që po, ne duhet të kemi dhe mbledhje të tjera në vazhdimësi, të bëjmë dhe një konkludim. Kemi bërë pesë dëgjime, po atëherë ku ka ecur puna, ku nuk ka ecur puna, si duhet të ndryshojmë metodologjinë, duhet të shtojmë njerëzit e thjeshtë, sepse unë kam dëgjuar për shembull në dëgjime për të cilat nuk jam dakord. Nuk mund të flasi një drejtor i një bashkie objektivisht për reformën territoriale, është krejtësisht e pamundur. Nuk mund të flasi një administrator, nuk është qytetar, në kuptimin bruto të fjalës, sepse është i kufizuar nga puna që ai bën dhe ajo që e plotëson këtë puzzle, që ne duam ta plotësojmë, janë dëgjimet me komunitetet. Ato janë dëgjime pastaj bruto fare, që ne duhet t'i stimulojmë, t'i shtyjmë përpara dhe t'i realizojmë. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Dy komente të shkurtra për interes publik, besoj që më pas t'i japim udhë gjësë. Së pari, argumenti që u tha këtu, që ne nuk duhet të shkojmë paraprakisht me idenë e koncentrimin, sepse pastaj pse u bëmë reformën dhe pse u bëmë analizën dhe pse u bëmë gjithë punën e ekspertëve, vlen 100% dhe në këmbën e kundërt. As nuk mund të bëjmë diskutimin dhe dëgjimet me idenë paraprake që t'i shtojmë bashkitë. Se e njëjta gjë vlen, pse po bëjmë analizën, pse po bëjmë vlerësimin? Pra, unë mendoj që këto në fakt koegzistojnë. Padyshim që është krejt normale dhe e drejtë që mazhoranca në vlerësimin e saj të punës së përditshme, të marrëdhënieve të përditshme me institucionet, me njerëzit, me gjërat, ka një opinion, është krejt legjitime që opozita të ketë gjithashtu një opinion dhe këto opinione duhet t'i verifikojmë, duhet t'i përballim dhe me opinionin e njerëzve dhe me opinionin e fakteve dhe me analizën. Pra, nuk ka asnjë problem te fakti që mazhoranca ka një pozicion, nuk ka asnjë problem te fakti që opozita ka një pozicion dhe procesi duhet

të bëhet që pastaj ta verifikojmë. Pra, argumenti që pse që nga tabu që mazhoranca ka një pozicion konsolidimi, ka të njëjtën vlerë në inversin e saj, në pozicionin që pse duhet të jetë tabu që opozita të ketë një pozicion përzjerje numrave. Kështu që kjo është, besoj, vetë evidente. Pjesa e dytë ka të bëjë me dëgjimet. Unë e mirëkuptoj problematikën, besoj se jemi treguar maksimalisht akomodues për t'i dhënë mundësi opozitës të jetë përfaqësuese dhe të ndihet e përfaqësuar në gjithë dëgjimet, të ketë mundësi të ketë zërin e saj në dëgjimet në territor. Po, unë, meqenëse e hapëm si diskutim publikisht, patjetër që një administrator i një njësie apo një person që është në funksion ka një detyrë dhe patjetër që bashkë me detyrën ka dhe ngjyrimin e detyrës së tij, identikisht siç e ka një ish-kryetar komune, i cili e ka dhe më të rëndë peshën se i ka ikur detyra që mund të kishte dhe ka dhe ngarkesën e historisë së vet. Kështu që, siç ne e kemi dhënë masivisht hapësirë për të folur çdo ish-kryetar komune që ka pasur opinionin e tij, duke e zhveshur ne nga ana jonë opinionin që them: "Dëgjo, ky ka një opinion të ngarkuar me pozicionin që ka qenë kryetar komune, me ndjesinë që sa keq që s'jam më kryetar komune, se sa mirë isha atëherë kur isha kryetar komune." Po do ta dëgjojmë prapë si prapë, sepse ka qenë, e kanë zgjedhur njerëzit, e ka ushtruar këtë detyrë, t'ia dëgjojmë opinionin e tij. Me të njëjtin respekt, besoj që duhet të dëgjojmë opinionin e dikujt që jo që ka qenë ish-kryetar, që e ka ushtruar dikur, por që e ushtron sot detyrën dhe ta kemi mundësinë t'i barazpeshojmë. Kështu që, kur hyjmë tek ky diskutimi, unë them që për fat të mirë po i hyjmë dhe e vumë këtë loop, do prishim një proces që për fat të mirë ja ka dhënë mënyrën e ekuilibruar njerëzve, si ish-kryetarëve të komunave, si ish-të zgjedhurve, si anëtarëve të këshillit bashkiak të një force apo një force tjetër, si njerëzve të angazhuar, si njerëzve të paangazhuar, si të njerëzve të shoqërisë civile që i kemi pasur dhe kanë thënë secili mendimin e tyre në proces. Kështu që, unë mendoj që kanë qenë të vlefshme për të gjithë palët dhe për publikun dëgjimet që e kemi bërë, në formatin që e kemi bërë. Nuk mund të shkojmë te logjika që do i fikim të gjitha zërat që s'na pëlqejnë, do lëmë vetëm zërat që na pëlqejnë, se nuk kemi sistem të mirëfilltë të dëgjimeve në atë mekanizëm. Po, ky është opinionimi im për të krijuar një ekuilibër funksional. Faleminderit.

Luçiano Boçi:

Më duket se nuk e kuptuat shtratin e parashtrimit tim, isha duke folur dhe duke mbështetur atë çka transmetoi zoti Mziu dhe bëra diferencën midis një dëgjime që vjen nga qytetarët, bruto nga komunitetet dhe dëgjimeve që kemi realizuar deri më tani. Nuk bëra një krahasim midis një drejtori administratori dhe një ish-administratori. Mora si shembull, për mos e zgatur shumë ligjëratën time, patjetër dhe një ish ka ngarkesën e tij, por është më qytetar se ai që është aktualisht administrator apo është drejtor. Po s'do i hyj këtyre gjërave, janë nuanca këto, por ajo që tha zoti Mziu ishte shumë e saktë dhe unë atë e mbështeta. Pra, duhet të vijojmë për këtë gjë, që mos e bëjmë edhe debat midis, se ne kemi shumë hapësirë edhe përtej komisionit për të bërë debate për teza të tilla, se duhet t'i kalojmë fjalën edhe kolegëve, por që ne të nisim një punë keq, po u nis keq, vazhdon keq dhe përfundon keq. PD-ja nuk kishte shprehur një qëndrim të saj pa marrë një raport vlerësimi për reformën e 2014-s, pa bërë dëgjimet, deri kur në grupin parlamentar të Partisë Socialiste u shpreh varianti ose variantet, në fakt, një variant është ai, por ka disa pamje, që duhet të avancojmë drejt koncentrimin të numrit të bashkive në mënyrë paraprake, që unë e konsideroj vendim politik paraprak që imponon dhe punën e komisionit dhe ekspertëve. Ndërkohë që në komision ishte thënë që ne duhet të presim raportin e vlerësimit, duhet të presim dëgjimet, sepse baza e nisjes është a ka dështuar apo pati sukses. Në qoftë se nuk ka dështuar sipas jush, po pse bëhet reforma? Ju jeni qeveria, nuk keni nevojë fare të uleni me opozitën, në qoftë se nuk kërkohet ndryshim harte për të korrigjuar këto gabime dhe të vazhdoshit atë planin strategjik që keni miratuar

në 2023-in dhe të avancoshit aty. Këtu është një situatë reale, konkrete. Ka dështim në raport me pritshmëritë, po e përsëris prapë, duhet korrigjuar, korrigjimi ku do të jetë? Sigurisht në territor. Korrigjimi nuk është që është përmbysje, korrigjimi është rregullim, është pozitiv, ajo që kërkojmë ne është pozitive dhe për më tepër nuk është qëndrim politik paraprak i PD-së, është qëndrim që ka dalë nga dëgjimet. Unë do të doja të kisha dhe raportin e vlerësimit, por unë kam dëgjimet, kam dëgjuar qytetarët, kam bërë një ballafaqim të dëgjimeve dhe ka dalë që qytetarët, në shumicën e tyre, kërkojnë që t'i afrohet shërbimi, kërkojnë që njësi bashkiake të jetë e vogël, kërkojnë që disa njësi që sot konsiderohen të vogla në raport me të mëdhatë, me Tiranën, Fierin, Durrësin, duan të qëndrojnë, se edhe ato ofrojnë shërbimin jo cilësor, por me mbështetje financiare që e kemi ndorë ne tani më në reformë ta rregullojmë, mund të jenë më mirë në performancën e tyre. Mund të vijojmë?

Bledion Nallbati:

Po.

Speaker 7:

Mendoja që.

Speaker 8:

E ke vetëm me mua zoti?

Bledion Nallbati:

E kam marrë? Faleminderit.

Speaker 8:

Të drejtohesha vetëm mua, thashë se mos...

Speaker 7:

Po, jo.

Bledion Nallbati:

Meqenëse kemi thirrë këta zotërinj për t'i pyetur se janë edhe në krye të detyrës edhe populli i pret, unë mendoj që ta fillojmë me dëgjimin dhe me pyetjet ndaj kryetarëve të bashkive. Së pari, dua t'i përshëndes dhe t'i falënderoj për prezencën dhe meqenëse e mora fjalën kështu si gjysmë për procedurë, po po e nis me 2-3 pyetje të shkurtra që besoj janë thelbësore. Në përvojën tuaj, dhe e kam për të gjithë ju, në përvojën tuaj tashmë nuk e di, ka disa që kanë disa mandate, për shembull shoh zotin Tafani që e kam njohur që në kohën kur kemi qenë kolegë, po s'e di të tjerët sa përvojë kanë. Dëgjomë.

Bledion Nallbati:

Po. Dhe t'i bie shkurt: në përvojën tuaj, mendoni që numri i bashkive, po e nis nga numri meqë është debati më i madh, duhet të ngelet ky që është, duhet të zvoglohet apo duhet të shtohet? E para. E dyta, decentralizimi. E për të gjithë? Për të gjithë, për të gjithë e mund të përgjigjen si duan. Përgjigjet secili. Po. Decentralizimi financiar. Edhe ai i kompetencave duhet të vazhdojë dhe në përvojën tuaj, ndjenjën tuaj, ka ecur siç duhet

me këtë reformë apo do të duhet të ecë më tej? Duhet të keni më shumë kompetenca, më shumë decentralizim financiar? Dhe si ndikon në opinionin tuaj si kryetar bashkish dhe si njerëz që e njihni mirë terrenin, problematikat dhe shërbimet? Nëse ulet numri i bashkive dhe si ndikon nëse rritet numri i bashkive? Këto treja njëherë si fillim, pastaj... Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit zoti Albani. T'i japim fjalën kryetarëve me radhë si ta gjykojnë. Po.

Arif Tafani:

Të nderuar anëtarë të komisionit, unë jam Arif Tafani, kryetar i Bashkisë Belsh. Do ta filloja nga përvoja ime personale, pasi kam qenë për fat kryetar i një njësie të vogël para reformës së 2014-s dhe kryetar i Bashkisë Belsh mbas reformës dhe do të thoja që Belsh është rasti më i mirë, për të mos thënë ideal, i suksesit të kësaj reforme. Belshi, nga një vend i panjohur, nuk njihesh fare në hartë, sot është kthyer një nga destinacionet kryesore turistike, kryesisht fundjavës, të vizitorëve të brendshëm, por prej viteve të fundit dhe vizitorë të huaj, ku ka kaluar numrin e vizitorëve vjetor mbi 250 mijë. Përbëhet nga njësia Belsh dhe katër njësi, pra katër ish-komuna, dhe para vitit 2014 as bëhej fjalë për disa funksione apo shërbime. Siç është menaxhimi i mbetjeve, ku para 2015-s.

Arif Tafani:

Realizojnë në qytet dhe 3-4 fshatra në Kurorën e Liqenit, dhe sot është në 100% të territorit dhe të 100% të popullsisë. Po kështu, funksioni i pastrimit të kanaleve kulluese dhe ujitëse, dhe mirëmbajtja, riparimi tashtuquajtur rrugë bujqësore, rrugë parcelave, pra, nuk jepej para, nuk ekzistonte si shërbim, dhe nga viti 2016. Po mund të vazhdojmë me shërbimin e zjarrfikëseve, mund të përmendim shërbimin pyjor, shërbimin social, mbiel që ka edhe një qendër sociale për trajtimin e moshës së tretë dhe familjeve në nevojë. A ka vend për përmirësim? Patjetër, sepse të administrosh një komunitet dhe një territor, paratë nuk mjaftojnë asnjëherë. Edhe në bashki shumë më të mëdhaja, jo më për një bashki rurale si Belshi. Por unë nuk do t'i futem këtu ndarjes territoriale apo territorit, si pyetje në vetvete.

Bledion Nallbati:

Vetëm një sekondë, lutem, dhe me gjithë respektin zoti Tafani, tani unë e kuptoj që një kryetar bashkie do të bëjë dhe bën shumë mirë që bën një ekspozitë dhe një promovim të bashkisë së vet, sepse është normale, është detyrë parësore e tij, por ne nuk ju kemi thirrur këtu për të bërë reklamën e bashkive, por për të bërë disa pyetje të thjeshta si njerëz me provojë për të kuptuar se çfarë duhet të bëjmë me këtë reformë. Dhe pyetjet e mia ishin të thjeshta, duke kërkuar një përgjigje të thjeshtë nga gjithsecili prej jush, edhe pse ju ndoshta nuk do të donit ta jepni opinion, por për aq kohë sa jeni atje do të duhet ta jepni opinion. Duhet, e para ishte, njësitë vendore do të duhet të qëndrojnë siç janë, do të duhet të shtohen, do të duhet të pakësohen. E para. E dyta, a ka qenë i mjaftueshëm dhe si duhej decentralizimi financiar dhe decentralizimi i kompetencave? Dhe e treta ishte, në opinionin tuaj, si ndikon shtimi ose pakësimi i njësite vendore? Këto tre pyetje kisha unë dhe deri tani nuk po dëgjoj. Jam i vetëdijshëm që gjithsecili që do t'i jepet një mikrofon, çdo kryetar i bashkie do ta bëjë një ekspozitë dhe një reklamë, një promovim të bashkisë së vet, është normale. Po të lutem, mund të na jepni përgjigje për pyetjet që ne bëjmë, sepse ne duam të kuptojmë çfarë ndikimi kanë këto në territor dhe se si duhet të konceptohet reforma e re.

Arbjan Mazniku:

Zoti Nallbati, me gjithë respektin, mendoj që do të duhet të ruajmë një parim që ne si anëtarë komisioni të ruajmë të drejtën ekskluzive të pyetjeve? Jo, jo, jo, nuk thashë, dëgjo, dëgjo, nuk... po më le ta mbaroj fjalinë se... më le ta mbaroj fjalinë se... më le ta mbaroj fjalinë se nuk do të thosha atë që mendova që do të thosha. Ne do të ruajmë të drejtën të bëjmë pyetje, do të dëgjojmë përgjigjen deri në fund të të gjithë njerëzve, besoj se kjo është gjëja normale të bëjmë. Nëse përgjigjja është jo në përputhje me pyetjen, kemi drejtë ta ribëjmë pyetjen dhe ta themi, po njerëzit i detyrojmë të themi atë që duam ne s'e bëjmë dot. Pra, nëse pyetja... një sekondë, nëse pyetja nuk është... dhe megjithëse është e para, them na bëni... nëse pyetja nuk është... ta lëmë si fillim secilin person, kushdo qoftë ai, ta thotë përgjigjen e tij. Hajde të caktojmë një kohë, dy minuta, tre minuta, një minutë e gjysmë, ta thotë përgjigjen e tij si e mendon ai. Nëse s'na pëlqen përgjigjja, t'i themi: "Zotëri i nderuar, nuk e mora përgjigjen për pyetjen time, të lutem këtë, këtë." Po ta lëmë se ndoshta, ndoshta do të shkonte te ajo pika... e kuptoj, e kuptoj qartësisht, po besoj që jemi të gjithë njerëz të rritur dhe të kuptohemi me njëri-tjetrin. Faleminderit.

Luçiano Boçi:

Mirë, zoti Natbati këtë kërkoi, bëri pyetje, nuk mori përgjigjen për të bërë vlerësimin. Jo, e mbaroi zoti Tafani.

Arbjan Mazniku:

Jo, mor po s'e mbaroi.

Luçiano Boçi:

Po pyet... dhe përgjigjet...

Arif Tafani:

Jo, unë isha duke u përgjigjur, pyetjen e kuptova shumë mirë, nuk e kuptoj padurimin në fakt. Sa për pyetjen e parë, çfarë mendoja duhet të zvoglohen dhe apo të rritet numri i njësisë? Unë jam kryetar i bashkisë Belsh, përfaqësoj bashkinë Belsh, komunitetin tim dhe nuk kam ndonjë opinion. Në lidhje me decentralizimin, po, ka shumë gjëra që duhet të përmirësohen. Një është autonomia financiare, financimi më i mirë i funksioneve deleguara, dhe rishikimi i formulës së grantit dhe transferit të pakushtuar. Sa për pyetjen tjetër, pra kjo është pjesë e juaja, e komisionit, unë kam ardhur t'i përgjigjem pyetjeve që kanë lidhje me komunitetin e Belshit. Shumë faleminderit.

Luçiano Boçi:

Ja, zoti Natbati...

Arbjan Mazniku:

Po e japim fjalën të gjithë kryetarëve?

Jo, jo, meqenëse e bëri për gjithë kryetarët, t'i japim secilit kryetar fjalën.

Bledion Nallbati:

Dakord, dakord. Shiko, ora unë e kuptoj sikletin që kanë kryetarët e bashkive, dhe presionin që i vjen nga pushteti që mos shprehen në lidhje me numrin, sepse jam i sigurt që gjithsecili prej tyre e ka një opinion ndoshta shumë më të mirë sesa të gjithë ne që jemi këtu në parlament, se ata përballen çdo ditë me qytetarë dhe e njohin më mirë se kushdo tjetër. Tani, mund të mos shpreheni se e kuptoj unë sikletin, por që të më thuash nuk e kam një opinion, kjo çëdon, çëdon si përgjigje. Megjithatë, ajo është e drejta juaj, thoni... pastaj, po kështu i bie që bëjmë kot dëgjesa me kryetarët e bashkive se nuk kanë një opinion, se nuk e thonë dot një opinion dhe e lëmë.

Arif Tafani:

I nderuar, unë mund të them vetëm që po, Belshit duhet të qëndrojë bashki.

Bledion Nallbati:

Pyetja nuk ishte e tillë, por si ishte...

Arbjan Mazniku:

Jo, nuk i kërkoj këtë, po... tani, zoti Nallbati, si fillim, jo, jo, si... dhe bëri shumë mirë që e mori. Tani, e vetmja... jo, pra dakord, unë dua vetëm... unë s'kam thënë asnjë fjalë, unë vetëm kam tentuar të koordinoj gjënë. Kërkesa që kisha është, meqenëse... po flas vetëm për çështje operacionale. Meqenëse zoti Nallbati ia bëri pyetjen të gjithë kryetarëve, unë vlerësoj që do të ishte shumë e udhës ta dëgjonim nga të gjithë, përgjigjen nga të gjithë. Para se të kalojmë në pyetje të tjera, ta marrim nga të gjithë kryetarët, se secili ka me të drejtë opinionin e vet për territorin e vet, ta marrim përgjigjen nga të gjithë. Kështu që do të doja t'i ftoja secilin kryetar të thotë përgjigjen e tij. Faleminderit.

Nuri Belba:

Përshëndetje të gjithëve. Unë dua ta nis faktin me një përshkrim të reformës së 2014-s. Ne jemi të gjithë dëshmitarë që u bë një reformë dhe qëllimi i kësaj reforme ishte që...

Po prit më tani, po të mbaroj... po prit më, se më ka dhënë fjalën ai për ritmin. Tani, neve ju kemi... ne ju e kemi... dëgjo, me gjithë respektin, ne si kryetarë bashkie ju kemi dëgjuar juve përdita.

Luçiano Boçi:

Zoti Belba. Ja një ndërhyrje, zoti Belba.

Edhe ne i vlerësim.

Zoti Belba.

Nuri Belba:

O zotëri, njeriu ka thënë një fjali dhe unë duhet të dëgjoj vetëm një orë se ai nuk e mbaroi shkrimin e mirë që të vijë të japin opinionin tonë. Në qoftë se reforma territoriale ka aktorë që janë...

Luçiano Boçi:

Ja, zoti Belba, një minutë se jam drejtuesi i komisionit, një minutë, respektoj këtë gjë.

Luçiano Boçi:

Kur ndërhyt zoti Mazniku, nuk ka ndërhyrë deputetët e tjerë. Tani nuk jemi në studio televizive, ku gazetari bën pyetjen dhe unë i jap çfarë përgjigje dua dhe kam ndërmend. Tani këtu jemi para një komisioni, nuk është hetimor, sigurisht, është dëgjues, por ama nuk është edhe show që ne ta bëjmë në formë të tillë. Parashtrimin, në qoftë se keni për reformën që janë domosdoshme, shumë mirë, bëj me shkrim dhe na i dorëzon ne në komision. Këtu nuk kemi për të bërë parashtrime të parapërgatitura, të lutem, ta çojmë deri në fund.

Nuri Belba:

Po themi, tani do krahasojmë reformën e 2014-s.

Luçiano Boçi:

Ja ta çoj deri në fund.

Nuri Belba:

Ne jemi duke zbatuar atë reformë.

Luçiano Boçi:

Zoti Belba, se ka një rregull...

Nuri Belba:

Kush ka shkuar mirë, kush ka shkuar keq.

Luçiano Boçi:

Zoti Belba, unë e di që e njihni procedurën parlamentare. Ka një rregull, ja ta mbaroj unë, dhe ajo që unë po kërkoj s'ka të bëjë fare, domethënë, për të kundërshtuar parashtrimin tuaj. Në qoftë se keni një opinion, bëjeni me shkrim dhe dorëzoheni sot je për dhënë përgjigje për pyetjen që deputetët bëjnë. Kaq e thjeshtë, se duam dhe ekonomik kohë nuk kemi dhe se kështu, e di si vazhdoj, me ju ne jemi deri në darkë me parashtrime, me gjëra se normal ndoshta keni dëshirë, na keni dëgjuar, keni qejf të na kundërshtoni. Me dokumenta na i dorëzoni, ekspertët i kemi dhe ata i vlerësojnë. Përgjigjen për pyetjet që bën deputeti, shkurt, qartë, saktë.

Arbjan Mazniku:

Tani, tani të lutem se nuk e zgjidhim këtë çështje duke bërë tre njëjtën pyetje. O zoti Albati?

Nuri Belba:

Neve nuk kemi të drejtë vote, do shkruajmë apo s'do shkruajmë?

Unë...

Nuri Belba:

Unë pyet mu sikur jam deputet, unë jam kryetar i bashkisë. Tani...

Zoti, zoti Nallbati, po ke respekt siç kam unë për ty, dakord?

Arbjan Mazniku:

Përpara se t'ia japim fjalën sërish zoti Belba, ka edhe një fjali, po të them një fjalë të lutem, edhe këtë e kam shumë të rëndësishme dhe thelbësore për mundësinë që t'i vijojmë këto gjëra siç duhet. Do bëjmë dakord për një gjë që ta zgjidhim këtë punë për të gjithë dëgjesat. Ne bëjmë pyetjen, do i japim njeriut dy minuta ta thotë si e mendon ai. Hajde të caktojmë sa minuta duam, dy minuta, tre minuta, në fund fare secili prej nesh këtu, e para i ka mendtë e veta në kokë, e dyta ka një përgjegjësi para publikut për të thënë të vërtetën që mendon vetë. Do bie dakord që nuk do shkojmë te fjalia e parë që thotë njeriu, të kërcejmë shtatë vetat ndërhyjnë. Do ta bëjë pyetjen një person sa të dojë ta bëjë, një minutë, një minutë e gjysmë, dy minuta, të mbarojë pyetjen, më pas nëse do ia drejtojmë katër vetave, pesë vetave, një njeriu pyetjen, atij njeriu për çështje qytetarie dhe etike parlamentare do themi ke dy minuta të përgjigjesh. Nëse përgjigjja nuk është në përputhje me kërkesën tuaj, nuk ju ka kënaqur, keni drejtë të bëni një pyetje të tjerë, të thoni kjo pyetje nuk i përgjigjet pyetjes time, por ama nuk mund të paragjykojmë fjalinë te fjalia e parë se nuk na pëlqeu si e tha fjalinë e parë folësi. Kushdo qoftë ai, t'i japim...

Bledion Nallbati:

Dhe do të bie dakord edhe për një gjë që këtu nuk jemi mbledhur për të bërë show. Jemi mbledhur në një komision për një reformë nga më të rëndësishmet në këtë vend dhe gjithsecili prej nesh duhet të kuptojë që nuk jemi mbledhur për të bërë show. Në qoftë se vijmë këtu me përgjegjshmëri, duhet të vijmë për të dhënë opinionin për ato çështje që janë kaq të rëndësishme për qytetarët, jo për të bërë show. Dhe për këtë duhet të biem dakord.

Arbjan Mazniku:

Zoti Nallbati?

Bledion Nallbati:

Me gjithsecilin prej nesh.

Arbjan Mazniku:

Çfarë është serioze?

Bledion Nallbati:

Qoftë me ne që jemi anëtarë të komisionit, qoftë me ata që vijnë të ftuar këtu për të dhënë opinion.

Arbjan Mazniku:

Shumë respekt sërish. Secili prej nesh ka mendimin e tij dhe opinionin e tij dhe këtu e themi për njëri-tjetrin, e themi edhe për publikun që na thotë. Çfarë është serioze? Ti ke gjykimin tënd, unë kam timin, publiku ka të vetin që na gjykon e na vlerëson dhe unë mendoj që gjëja serioze dhe civile për të bërë, minimalja e kulturës bazike është, ne bëjmë pyetjen tonë, me kohën që na duhet, i lejmë personit që të flasi dy minuta, tre minuta, një minutë e gjysmë, hajde ta bëjmë dakord sa doni juve, po t'i japim mundësinë njeriut ta nisi, ta mbarojë fjalinë me kryefjalë kallëzues kundër injor deri në fund, se nëse njeriu sa

ka thënë një fjalë, kërcen gjashtë veta, nuk kemi për të shkuar shumë larg. T'i japim dy minuta të thotë sa dojë.

Bledion Nallbati:

Pse po e marrim ne kohën me debat? O zotëri, tani të lutem, unë bëra tre pyetje shumë të thjeshta. Thjeshta fare që mund të përgjigjesh me një fjalë. Tani ti më thua t'i japim kohën të bëj teori. Unë nuk kërkova nga zotëria të më japë opinion mbi reformën. I thashë, bëra tre pyetje shumë të thjeshta. Tani në qoftë se ne e nisim përgjigjen, unë pyes për Ramadanin, e ti më përgjigjesh për Mondin, s'kam çfarë të dëgjoj kot.

Arbjan Mazniku:

Në Republikën e Shqipërisë, në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë është e cilësuar e drejta e mendimit të lirë dhe e fjalës së lirë. Tashi, dhe në komision, njerëzit kanë mendimin e vetë dhe fjalën e vetë, e thonë si e thonë ata, jo si do...

Luçiano Boçi:

Po jo, po s'bëhet kjo.

S'ka gjë se nuk...

Arbjan Mazniku:

Zoti Haxhinasto kishte një koment.

Luçiano Boçi:

Ja se kam unë një, më fal Mondin, diçka, domethënë vetëm një fjalë. Nuk jemi këtu për të bërë pamjen para publikut, edhe si deputet, më falni, edhe si deputet apo si kryetar bashkish. Ka momente tjera kur dalim para opinionit publik, ka parafushata, fushata edhe rregullime tjera. Sot jemi për të bërë detyrën. Ne si anëtarë të komisionit, unë këtu kam ardhur si bashkëdrejtues i Komisionit të Reformës Territoriale dhe nuk do bëj show tjetër që të thojë publiku sa bukur e tha, sa mirë e tha. Jo, më jemi këtu me njëri-tjetrin për t'u ballafaquar ne. Dëgjesa është ballafaqim dhe ballafaqimi kërkon që të jepen përgjigje për pyetjet reale që bën deputeti. Si jemi ne në trysinë, si e mendon publiku? Publiku si e mendon e thotë në dëgjese publike. Sot jemi si e thotë kryetari i bashkisë çështjen që e ka shqetësim deputeti, po ta dëgjojmë prapë atë po kërkon Bledioni.

Arbjan Mazniku:

Po s'e kemi dëgjuar akoma ose s'kemi lënë me fund mikrofonin?

Speaker 1:

Më fal zoti Haxhinasto.

Edmond Haxhinasto

Me thënë të drejtën, faleminderit dje që më dhatë fjalën. Me thënë të drejtën, e pritsa këtë moment që të dalim nga një rregull i cili duhet të ishte vendosur prej kohësh që në seanca të tilla pyetje-përgjigje, pyetja është e qartë, duhet të jetë e qartë përgjigjja. Nuk ka vend për as për retorikë, as për kalim degë mbi degë. E para. E dyta, kam një vërejtje për ju të dy bashkëqytetarët, se mbledhja ka qenë në orën 10:00, ne në 11:30 kemi filluar të bëjmë

pyetjet tona. Tani kjo nuk është më e mundshme. Edhe nuk mundesh, por ka një orë që është e çdo ditë që të marrësh një pyetje shtesë çdo orë që është e çdo ditë. Ju lutem, vendosni ju të dy, bashkëqytetarët, i nderuar bashkëqytetar, kohën për përgjigjen e pyetjes. Dy minuta dhe kaq. Ose tre minuta, ose ju gjykoheni. Me qëllim që të kemi të gjithë mundësinë të pyesim dhe zotërinjtë të kenë mundësinë të përgjigjen. Tashi, nuk është vendi këtu për të bërë paraqitje dhe parada politike, edhe suksesesh. Duhet të kemi t'i qëndrojmë përgjegjësisë që kemi për të bërë reformën. Është shumë e rëndësishme, e kemi thënë që në fillim dhe kemi shprehur konsensus që duhet të dalim përtej interesit politik. Nuk është interesi politik këtu në këtë mes, është interesi i qytetarëve. Prandaj ju lutem shumë t'i lëmë mënjane këto retorikat, të fokusohemi dhe të vendosim një ritëm te puna e komisionit, përndryshe do të gjenerojë keq kjo.

Arbjan Mazniku:

Zoti Haxhinasto, jam shumë dakord me komentimin. Mendoj që t'i japim dy minuta kohë secilit kryetar për të bërë përgjigjen e tij. Do t'i japim të pandërprera dashtësisht.

Nuri Belba:

Mirë, atëherë ndjesë për sa shkoi, për arsye se nuk ju e morët sikur unë po bëj show, por në fakt nuk po bëj show. Unë po vij po them sa të vërteta të cilat ne i kemi në territor. Nuk po flas për të thënë që ishte 2014-ja reforma, por dua të them që Bashkia e Prenës është bashki e krijuar nga tre njësi vendore, ish-komuna dhe bashkia. Në 2014-ën në Prenë nuk kishte qendrën komunitare për trajtimin e fëmijëve masivë të kufizuar. Sot ka. Edhe kjo ka ardhur për arsye se janë bashkuar të treja këto njësi bashkë me bashkinë. Në 2014-ën në Prenë nuk kishte asnjë rrugë të çliruar me asfalt. Sot ka tetë fshatra, tre njësi janë lidhur me asfalt, vetëm nga granti i bashkisë edhe tarrat e bashkisë. Pra, kjo tregon që bashkimi i këtyre, si thoni ju, më mirë gjen një drejtor urbanistike në Qukës, apo duke qenë në Qukës, në Prenë, në Raisën, në Stravajë? Kështu që kjo reformë e 2014-s ka qenë reforma e duhur. Ka probleme për rritje, për përmirësime e kasat dush. A ka problem për dezentizimin e kompetencave të kryetarit të bashkisë që të ketë më shumë? Duhet të ketë. Ne do të fillojmë edhe me një sidrims aktive. Ne ta shikoni, kemi dhe reformën territoriale, atë aneksat që do bëhet për pjesën e zgjedhore, të shikohet. Aneksatorët duhet të zgjidhen. Ose shikohet roli i kryetarit të fshatrave, ose këshillit anëtarë të këshillit të bashkisë të jenë nga çdo njësi. Mos jenë me një listë që bie partia dhe i fut vetëm që janë në bashkisë, por të kenë përfaqësim që i të ngrejne problemet e zonës. Kemi probleme tjera pastaj. Delegimin e kompetencave kanë ardhur në bashki, kanë ardhur me mbështetjen e qeverisë, kanë ardhur me paketë financiare. A është e duhura kjo? Duhet shtuar, duhet shtuar. A duhet financat vendore, ligji për financat vendore të parashikojë që renda minerare të kalojë e gjitha në bashki, siç kemi ne guroret apo kemi edhe minierat? A duhet për shembull që te po te ligji që të përmirësohet përsa i përket edhe hesheve t'i kemi në territorin tonë që ne të marrim një pjesë të asaj shume? Përse i përket pastaj burimeve njerëzore, e thashë edhe njëherë, nuk e gjen dot një drejtor urbanistike në Qukës, një në Stravajë, një në Raisë, por një në Prenë s'i gjenë. Ne jemi çdo ditë në territor. Nuk është kjo reformë ishte skandal, nuk ka shërbime. Si shërbime nuk ka? Sot në njësinë Stravajë i ke të gjithë shërbimet. Është njësi që është 20 km larg bashkisë. Në qytet i ke të gjitha. Në Raisë po ashtu. Në Qukës i ke. Ne të gjitha shërbimet i kemi online, sipas falë sistemit që është bërë nga i Albania. Tani do bëhet edhe sistemi për i bashkisë që do jetë pjesë e shërbimeve. Pjesën e drejtorisë së shërbimeve të kemi organizuar në atë formë që ju bën shërbim të gjithëve. Kemi kanale lëvizëse deri para 2014-ës, nuk kapte njeri me dorë. Pastrimi ka shkuar në 80% të sipërfaqes së bashkisë. Përpara ishte vetëm ke, siç e tha parafolësi, kryetari Belshi, që ishte te qendra e bashkisë edhe dy

fshatra që dukeshin në rrugë kryesore. Tani çfarë ka për të përmirësuar? Unë themi, nuk mund të marrim bashkitë që janë joeficiente, që janë me 3000 banorë, 4000 banorë, se zotëria të pyesë sikur ne do japim mendim sa bashki duhen në territorin e Shqipërisë. Ne flasim për komunitetin tonë që përfaqësojmë. Në Prenë, në qershorin e 2023-it, nuk ka ikur njeri. Të gjitha bashkitë tjera e keni, e merr e ke instati, nuk ka lëvizje popullore në mënyrë të ndjeshme. Kjo do të thotë që ata njerëz kanë zgjedhur të rrinë në atë zonë, janë përshtatur me kushtet dhe me punën dhe me të gjitha. Kështu që kaq isha, se u tremba për të bërë show.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Kalojmë te zoti Maç.

Bledion Nallbati:

Po që mbas përgjigjes do bëjmë një koment, se nuk mora asnjë përgjigje. Pra, pra, e para nuk më dhatë asnjë përgjigje në lidhje me pyetjet që ju bëra. Duhet të qëndrojnë siç janë, duhet të shkrihen, duhet të bashkohen në bashki tjera, apo duhet të ndahen në bashki më të vogla? Dhe në atë argumentin që ju dhatë, në logjikën që përdorët, thatë të gjitha këto suksese në bashkinë Prenë s'kanë erdhur nga bashkimi i njësive administrative. Pra, kjo do të thotë në logjikën tuaj i bie më mirë që edhe bashkitë tuaja të vogla të Qarkut të Elbasanit, Prenë si për shembull konkretisht, do jetë më mirë sikur të shkrihet dhe të bashkohet me Elbasanin. Këtë logjikë thatë ju. Erdhi nga bashkimi, thatë këto suksese erdhën nga bashkimi i tre njësive.

Nuri Belba:

Po flasim, po flasim nga 3761.

Bledion Nallbati:

Pra kështu i bie edhe njëherë po të them, jo mos më ndërriso, mos më ndërriva, edhe njëherë, sepse nuk më dhatë përgjigje. Atëherë po e riformuloj pyetjen mbas logjikës që ju thatë. Do të është më mirë kështu siç është Prenësi, apo do të jetë më i mirë edhe më i fortë shërbimi sikur të bashkohet me Elbasanin? A ka mundësi të përgjigjesh?

Nuri Belba:

Tani unë ta thashë, Prenësi, po ti nuk le të flasësh tani, çka të them unë. Ti edhe aq sa fole, unë i fola kështu sikur i mora hua. Tani, Prenësi ka një njësi në Stravajë që është 23 km larg njësisë tonë. E para. Tani Prenësi ka qenë në 10 bashkitë me preferencë më të mirë financiare. Po, duhet të qëndrojë, çfarë? Kaq. Duhet të qëndrojë me... Po s'po them më të qëndrojë tani. Ore.

Arbjan Mazniku:

Okej. Zotëri Maç. Po i bën pestë, nuk ka pse harrojmë, se secili do japë përgjigje.

Po jo, s'ka nevojë t'i japim përgjigje të gjithëve, përgjigjet do japin në fund të gjithë bashkërisht. Pasi bëj një pyetje, një koment në fund.

Po çfarë përgjigjesh duhet t'u japim njerëzve që i kërkojmë të ndajnë me ne eksperiencat e tyre? Na japin një përgjigje dhe të më japin...

Meqënëse zonja Bylykbashi e mirëkuptoj, e mirëkuptoj shqetësimin, e mirëkuptoj...

Zonja Bylykbashi

Jo, jo, se kemi edhe të ardhmen, kemi ardhur në qendër të bashkisë.

Arbjan Mazniku:

Zonja Bylykbashi e mirëkuptoj shqetësimin tuaj. Meqënëse pyetja ishte e drejtuar për të pestë...

Speaker 2:

Për nëntë vjet.

Arbjan Mazniku:

Zonja Bylykbashi e mirëkuptoj shqetësimin tuaj. Meqënëse pyetja ishte e drejtuar për pesë kryetarë, besoj që është krejt e udhës t'i japim mundësi secilit kryetar për këtë pyetje të përgjigjet. Më pas do i japim pyetjen ë, po pa ndërprerje, dhe në fund pastaj pa ndërprerje. Hajde. Okej. Zoti Maç.

Bukurosh Maçi:

Po, faleminderit. Bashkia e Peqinit me reformën e 2015-s ka funksionuar shumë më mirë. Ish-komunat apo njësitë administrative siç është njësia administrative Karinë, Gjocaj, Përparim, Pajovë, Shezë edhe qendra që është Bashkia e Peqinit, nuk kanë pasur atë kujdesin e duhur nga të gjitha drejtimet. Unë nuk po i hyj dhe nuk po zgjatem për atë çka folën dhe ish-kolegët këtu, por gjithçka ka funksionuar shumë më mirë. Në Bashkinë e Peqinit është rritur ndjeshëm shërbimi, patjetër investimet, janë disa investime që ish-njësitë administrative nuk do t'i bënin dot siç ishin. Në përgjigje të pyetjes për Bashkinë e Peqinit, po, patjetër ka shumë arsye historike që Bashkia e Peqinit duhet të qëndrojë bashki. Dhe po desha t'ju flas për historinë dhe arsyet, po besoj se i dini. Pyetja tjetër, nuk e di kush ishte... Ndotri. Patjetër që Bashkia e Peqinit ka shumë arsye që duhet të rrijë bashki. Faleminderit.

Mariglen Disha:

Përshëndetje të gjithëve. Bashkia e Librash do të mbështesë nismën për reformën territoriale si një mundësi e mirë për të rritur cilësinë e shërbimeve dhe zhvillimin e zonave tona. Jemi të gatshëm të kontribuojmë që kjo reformë të jetë sa më shpejt në shërbim të qytetarëve dhe të komunitetit tonë. Faleminderit.

Florenc Doka:

Përshëndetje. Prej disa muajsh tashmë jam kryetar i bashkisë së Rrikë, por me qeverisjen vendore kam nisur punë në vitin 2001. Para vitit 2014, besoj e dini mangësitë që kanë qenë në komunat. Kam qenë jurist i jashtëm në 19 njësi vendore të Qarkut të Elbasanit, të djathta dhe të majta. Arsyeja e vetme që kam qenë jurist në ato njësi është sepse shumica e tyre nuk kishte realisht juristë. Pra, burimet njerëzore kanë qenë minimale para vitit 2014. Sot, Bashkia e Rrikë vazhdon të mos jetë joshëse për staf të specializuar, sidomos inxhinierik, staf për aplikim projektesh dhe staf i kualifikuar. Kjo sepse pagesat, duke qenë niveli i pagave sipas numrit të popullsisë, është minimal, pra është i ulët. Për t'i dhënë përgjigjes rolin e saj se si dhe duhet të jetë Bashkia e Rrikë, gjykoj se patjetër

Bashkia e Rrikë sot është e gatshme që të zgjerohet, pra të jetë më e madhe. Edhe pse ne jemi sot bashkia e dytë me numër popullsie në nivel qarku pas Bashkisë së Elbasanit, prapë mendoj që kemi nevojë për fuqizi financiar, fuqizim, mundësi pagese për punonjësit për të rritur stafin dhe cilësinë e atyre punëve që ne kërkojmë të bëjmë. Punët janë shumë të mira. Thashë, duke qenë se kam një eksperiencë të tillë, e di shumë mirë që të paktën pesë njësitë administrative përfshirë dhe të Rrikës që ne kemi pasur, i di shumë mirë punët që kam bërë. Pra, nëse në njësinë e Mollas para 2015-s u ndërtua vetëm një shkollë edhe një rrugë e asfaltuar, sot Mollasi ka tre shkolla të rikonstruara, pothuajse rrugët kryesore të asfaltuara. Është pjesë e bashkimit, apo jo? Unë gjykoj se vlera financiare dhe të ardhurat financiare kanë bërë detyrën e vet, sepse nëse deri dje me të ardhurat nuk paguhej as 40% e pagave, sot me të ardhurat paguhen 1.67% të pagave që i marrim nga të ardhurat. Pra, fuqizimi apo rritja territoriale e bashkisë gjykohet që në këtë rast është e nevojshme. Për sa i përket Bashkisë së Rrikë.

Ermal Elezi:

Atëherë unë po i ndaj, meqënëse kam tre pyetje, po mos t'i bëjmë që të përgjigjen të gjithë kryetarët. Në lidhje me bashkitë e Prenësit dhe Peqinit, dua të kuptoj, duke pasur edhe të dhënat financiare, cilat janë vështirësitë që ju hasni në mbledhjen e të ardhurave tuaja? Pra, të ardhurat e veta për banorë janë ndjeshëm më ulët se bashkia dhe Elbasan dhe Librazhë, ku nëse doni t'ju jap shifrat, po të dyja bashkitë janë nën performancë edhe të mesatares vetë qarkut, lëre më pastaj të nivelit kombëtar. Në lidhje me bashkinë Belsh dhe Thërikë, duke qenë se të dy kryetarët kanë... Po a mundem ta bëj pyetjen, apo? Të dy kryetarët kanë një përvojë të hershme në pushtetin vendor. Pyetja ime është: ka një parametër shumë të qartë tregues që përdoret dhe i matet nga OECD dhe nga Bashkimi Evropian, që është bashkëpunimi ndërbashkiak. Duhet të di si funksiononte koordinimi mes komunave dhe bashkëpunimi ndërbashkiak kur këto ishin të ndara. Si arrini ju të bashkonit në rolin e sekretarit të përgjithshëm apo në rolin e kryetarit? Dhe duke qenë se kryetari i Thërikut i përmendi, këtë e kam për kryetarin e bashkisë Librazhdë. Sa të lehtë e keni që të dëgjoni kapacitetet teknike, sidomos për sa i përket a ka urbanist, inxhinier, nëse keni planifikues urban, nëse keni inxhinier mjedisi, dhe sa atraktive është Librazhdi që të përmbushi këto lloj detyrimesh që i japim për shërbime? Këto janë pyetjet e mia. Nëse ka nevojë t'i përsëris, më thoni.

Nuri Belba:

Në lidhje me pjesën e taksave, vetë furnizimi i taksave të nivelit të caktimit, pasi neve si bashki kemi një pothuajse vetëm tarifatat, kemi shumë, se taksa nuk kemi, për arsye se tarifatat e shërbimit janë pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi. Të tjerat nuk janë taksa direkte. Kështu që nuk ka arritur niveli aq sa duhet. Unë e thashë edhe në para fjalës time që me Ligjin për Financat Vendore, përmirësimin e taksave që shkojnë kombëtare, të cilat duhet, sidomos një pjesë e tyre, masën e madhe 20% të kalojnë në bashki, pasi ne jemi në bashki që kemi ish-minierat, ose siç jemi duke punuar tani për riaktivizimin e pjesës së minierave, të cilat kanë filluar edhe pjesë e vizitorëve tuaj të vijnë, të afrohen, besoj që këto taksa do shkojnë edhe ku duhet. Por e thashë edhe njëherë, kjo ka qenë më shumë arsyeja që...

Ato që na i bie që unë thashë. Ligji neve...

Në Elbasanin e Librazhit është shumë i thjeshtë.

Po kanë më shumë biznese dhe prandaj kanë më tepër. Te ne s'ka biznese në Elbasan e Librazhë. Ka më shumë miniera, më shumë gurore, të cilat pothuajse te neve nuk

paguajnë asnjë taksë, me përjashtim të taksës së pastrimit, që edhe atë e mezi marrim. E dimë ne çfarë heqim duke bërë 100 shkresa. Kështu që kjo është e gjitha.

Bukurosh Maçi:

Pak a shumë është e njëjta përgjigje. Performanca e Bashkisë së Peqinit në lidhje me taksat është rritur nga viti në vit, por siç e tha dhe kolegu, Peqini nuk ka biznese të mëdhaja, nuk është buzë detit, edhe normal që të ardhurat janë aq, por çdo vit performanca e Bashkisë së Peqinit në vjeljen e të ardhurave është rritur goxha ndjeshëm. Faleminderit.

Arif Tafani:

Në lidhje me pyetjen për bashkëpunimin ndërkomunal para reformës dhe mbasë, do të thoja që ligji i vitit 2000 ka qenë tjetër nga 139 në 2015, në fakt, dhe unë nuk njoh raste, sepse jam kryetar i Bashkisë Belsh, njësisë së vjetër që nga viti 2000 deri në 2011, dhe nuk njoh raste të bashkëpunimit ndërkomunal, përveçse bashkëpunimit ndërmjet ose ndërlidhjes nga Këshilli i Qarkut për disa funksione, po përmend ndërtimet pa leje, policinë ndërtimore në atë kohë. Ndërsa sot, me ligjin e ri, ka raste të bashkëpunimit. Njësitë, shtatë njësitë e Elbasanit kanë krijuar SHA-në e tyre për menaxhimin e mbetjeve urbane.

Florenc Doka:

Po, krahas patjetër SHA-së që është krijuar për menaxhimin, është pjesa e pjesëmarrjes së bashkive në sjellje të kanalizimeve, që është bashkëpunim dhe kjo, por dhe... Po, për sa i përket pjesës së parë, duhet theksuar që kanë qenë si entitete të veçanta, entitete që pothuaj nuk funksiononin fare me njëra-tjetrën, sidomos problematika pasur në mbetjet urbane. Ka pasur konflikte mes komunave Gostim dhe Thërikë në një rast, ku mbetjet shpesh shkelnin kufirin për depozitimin e mbetjeve nga një komunë në tjetrën, dhe këto kanë qenë problematika që jo vetëm që nuk i sillnin të mira njësisë përkatëse, por dhe çdo njësi vendore kishte, si me thënë, landfill-in apo vendin, se nuk quhesh landfill, vendin e tyre të depozitimit. Në pesë njësi kishte secila pesë vende depozitimesh. Për sa i përket bashkëpunimit sotëm, patjetër që kemi bashkëpunim me bashkitë, edhe në kuadër të performancës apo të kërkesave për programin e performancës. Para pak ditësh nënshkruam një marrëveshje me Bashkinë e Elbasanit për trajtimin e mbetjeve të gjelbërta në Bashkinë Thërikë. Roli ka ndryshuar në mënyrë thelbësore edhe për kompetencat që jep ligji. Sa i përket kompetencave pikërisht që jep ligji, ato në fakt nuk i kanë sot, apo nuk i ushtrojnë sot të gjitha bashkitë, sepse ligji që është 39 është goxha i zgjeruar dhe i vlefshëm për bashkitë, dhe besoj se me kapacitetet që ne kemi sot, është e pamundur që këto kompetenca t'i ushtrojmë po vetë. Flas për Bashkinë Thërikë gjithsesi.

Mariglen Disha:

Para 2014-ës, ish-komunat nuk kryenin këto shërbime. Arsimi parashkollor, si çerdhe dhe kopsht, si dhe shërbimet të tjera, si mbrojtja ndaj zjarrit, pastrimet, strehimi social, planifikimi i rregullimit të territorit që komunat më parë nuk e bënin dot. Kurse sot bashkitë e bëjnë si pastrimin, si strehimin, si mbrojtjen ndaj zjarrit, por dhe planifikimin e rregullimit të territorit, sot e bëjnë bashkitë. Bashkia e Librazhdë, të ardhurat e veta për një vit...

Mariglen Disha:

Ne sot kemi drejtori e planifikimit të rregullimit të territorit, që përfshihet urbanistika, edhe kemi stafin të ngritur dhe të kompletuar.

Arbjan Mazniku:

Pse janë 61 me radhë? Dëgjojnë të gjithë kundërtën se...

Mariglen Disha:

Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Më falni, o të lutem, të lutem, të lutem, le ta ruajmë këtë rregull që vendosëm. Zoti Nallbati, t'i japim fjalën zotit Haxhinasto sot për bërë pyetjet e tij. Faleminderit shumë.

Edmond Haxhinasto:

Më parë do kisha dashur që edhe nga Bashkia e Elbasanit të kishte një përfaqësues, pavarësisht se kryetari është jashtë shtetit, por një zëvendës mund të kishte ardhur për të na... për t'iu përgjigjur pyetjeve që do bënim. E para. E dyta, qarku i Elbasanit është veçanërisht i rëndësishëm për t'u diskutuar, sepse është qarku i dytë më i varfër në Shqipëri dhe qarku i parë me largimet masive me emigracionin, kështu që... pa diskutim, analiza e tij dhe pyetjet që do... përgjigja e pyetjeve që do bënim kishte rëndësi relevante, shumë të rëndësishme. Nga të dhënat që kam, më rezulton që Peqini dhe Prenjasi janë ato që kanë performancë më të mirë brenda qarkut. Kanë pasur një rritje për periudhën 2016-2022 më të lartë se gjithë njësitë e tjera. Konkretisht, Peqini rreth 70%, Prenasi 62%, në të dhënat që kam këtu. Urdhëro?

Edmond Haxhinasto:

Për rritjen totale. Të ardhurave... Urdhëro?

Edmond Haxhinasto:

Po, po, të ardhurat veta. Jo, të ardhurat totale, totale. Po, po. Ndërsa performanca më e dobët është e Elbasanit, me 20%.

Totale, sigurisht.

Edmond Haxhinasto:

Totale pra, heterogjene. Të gjithë elementëve këto kanë performancën më të mirë në të dhënat që na janë dhënë nga grupi i këshilltarëve. Tani, vetëm kjo e hedh poshtë argumentin që madhësia qenka ajo që rrit performancën dhe rrit të ardhurat. Ky argument për Elbasanin, të paktën, bie. Kështu që unë do dëshiroja t'ju bëja këto pyetje, duke pasur parasysh se pushteti vendor kontributin e tij më të rëndësishëm e ka shërbimet ndaj qytetarëve dhe kontribut për zhvillimin e ekonomisë në njësitë e tyre. Pyetjet e mia kanë të bëjnë me këtë: Sektorët që garantojnë rritje më të madhe, cilët janë në bashkitë tuaja? E para, pra cili sektor ju japin ndërtimi, bujqësia, çfarë aktivitetesh ju japin rritjen ekonomike më të madhe? E para. E dyta, a keni potenciale të pazhvilluara, të pashfrytëzuara, të cilat do të dëshironit që t'i angazhoni në qarkullimin ekonomik dhe në rritjen e të ardhurave në bashkitë tuaja? Dhe çfarë potencialesh keni? E treta, cilat janë distancat maksimale nga qendrat e bashkive tuaja? Sa larg janë qendrat? Kush është fshati më i largët me qendrën e bashkisë? E katërta, a keni kthime nëpër bashkitë tuaja nga të emigruarit? E pesta, për sa i takon burimeve njerëzore, pagat, thoni ju, përcaktohen nga numri i popullsisë. Ky është një defekt shumë i madh. Pagat duhet të përcaktohen

nga niveli i të ardhurave dhe nga performanca. Gjykimin tim, sepse ky është motivimi që një bashki ka, kur mbledh më shumë të ardhura, ka të drejtë edhe të shpërndajë më shumë. Kështu që kjo çështje, jo vetëm me burimet njerëzore që keni, kapaciteteve që keni, por edhe mënyrës si menaxhohet nga ana juaj. Thënë kjo, pyetja ime është: Efikasiteti i burimeve njerëzore që keni, a ka të bëjë me përzgjedhjen tuaj të njerëzve që punësoni? Sepse më rezulton që administrata është rritur në mënyrë të jashtëzakonshme, ndërkohë që cilësia e shërbimeve nuk është aty. Pra, keni më shumë të punësuar, por keni më pak shërbime. Këto janë pyetjet që kam për ju. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Meqenëse janë gjashtë pyetje, mund të biem dakord që t'i japim tre minuta çdo kryetari për t'iu përgjigjur, jo dy, se kam përshtypjen që nuk i zgjatojnë dot në dy minuta. Se ishin gjashtë pyetje.

Atëherë, një moment të caktuar, nëse jeni edhe me shkrim, por meqenëse janë këtu.

Nuri Belba:

Po, e fillojmë me burimet njerëzore. Falë edhe vendimit të qeverisë për pagat, i cili pothuajse sa kemi filluar, që janë rritur pagat, ka pak ndryshime në lidhje me numrin e banorëve, por nuk është një ndryshim shumë thelbësor. Është bërë e mundur që të afrojmë staf të specializuar. Por ka edhe një tjetër ke vendimi i qeverisë, që nga targat e bashkisë, për pozicionet që ne kemi, siç janë drejtor urbanistike, apo që janë më të kërkuarit në treg, të ketë një diferencë të tipit nga targat e bashkisë. Biles, do kërkonim edhe kur të bëhet ligji për financat vendore, që neve, si kryetar bashkie, ose të kenë mundësi që të bëjnë diferencimin pak për ato specialitete që janë të kërkuara. Përsa i përket përzgjedhjes, unë besoj që ne më shumë, në fakt, kemi gjithë këto vite që punojmë, është mandati i dytë, kemi shtuar më shumë punëtorë shërbimesh, edhe sot që struktura është emëruar në dhjetor të 2025-ës, akoma i kemi paplotësuar disa vende të cilat nuk janë aq domosdoshme. Por kemi kujdes më shumë ke urbanistika, ke sektor juridik, ke shërbimin social, të cilin thashë kemi një qendër komunitare e cila ka një staf prej 10 vetash, që paguhet nga bashkia, ku trajtohen 64 fëmijë me aftësi të kufizuar, siç kemi dhe qendrën e moshuarve, në lidhje me potencialin e pashfrytëzuar. Qeveria na ka dhënë një mundësi që paketa e maleve, paketa e maleve na ka dhënë një mundësi që neve gjithë atë potencial që kemi në territoret tona ta shfrytëzojmë. Kemi dërguar hartat, presim aplikimet, edhe unë besoj, jam shumë besimplot, që shumë të rinj janë kthyer. Në Bashkinë e Prenasit kemi 24 blektorë që janë kthyer nga Gjermania, të cilët kanë ngritur fermat e tyre me dhijë dhe me dele, por kemi edhe me lopë. Kështu që ky është një tregues që ata kanë gjetur një ambient të përshtatshëm, janë kthyer nga emigrimi. Përsa i përket asaj që the në rritje me pjesën se ku shikoni rritje më të madhe, ne në fakt shumë shpejt, edhe kjo falë qeverisë, do ngremë shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor. Tani unë do flas, kur të flas si, dakord, me mua më... Tani, do ngremë, po ngremë shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, të cilat do na bëjnë të mundur që shumë fermerë të bashkohen, të kenë mundësi të shesin më shtrenjtë, edhe me kosto ta prodhojnë më ulët. Kjo do të jetë njëra anë. Deri tani, më shumë ne mbulojmë shpejt ato shërbimet që kemi, atë mushinarkën dhe pjesën e këtyre të tjerëve. Tjetra, kush ishte fillimi, se e fillova nga fundi? Për kë? Tani nuk është bërë deri tani se patëm punë të tjera për të bërë. Po të kishim patur dakordësinë tuaj, mbështetjen tuaj, do të kishim bërë përpara. Por i marrim këto gjëra që kanë qenë më të rëndësishme, edhe kjo është shumë e rëndësishme, kështu që do e bëjmë. Tani ju jeni këtu, prodhoni kontribut, dhe ne ju mirëpresim. Ne jemi përtej partive, siç jemi këtu, ne atje i kemi të majtë, të djathtë, i kemi të gjithë njëlloj. Biles, u

shkojmë a pimë kafën të gjithëve, pra ne kur shkojmë marrim votat, ata shohin, e vlerësojnë. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zoti Maçi.

Bukurosh Maçi:

Faleminderit, në fakt ishin disa pyetje, unë do mundohem t'i përmbledh. Në Bashkinë e Peqinit ka një interes të madh për paketën e maleve, nga qeveria, që është shpallur nga qeveria. Gjithashtu, gjithashtu Bashkia e Peqinit është, i gjithë stafi i Bashkisë së Peqinit është i përkushtuar për këto që, për këtë pyetje që u bët, pra ne funksionojmë si një ekip. Burimet njerëzore i kemi, por mendoj që gjithçka në mirëfunksionimin e një bashkie varet shumë dhe nga titulari, patjetër. Në lidhje me të ardhurat e Bashkisë së Peqinit, ose Bashkia e Peqinit më mirë është fokusuar në dy tregues kryesor, është bujqësia dhe zona e Peqinit, sidomos zona e Gjocëve, është me tregun më të mirë në Shqipëri, por edhe për eksportet e produkteve bujqësore, siç është edhe kultivimi i pjesëve. Gjithashtu, ne jemi fokusuar edhe tek turizmi. Bashkia e Peqinit ka investuar në turizëm dhe siç e dini ju që Bashkia e Peqinit është një bashki me histori të vjetër, ne kemi. Kemi kala në qendër të qytetit, kemi vijën e Gnatjes, kemi kullën e Sahatit dhe po investojmë në turizëm, edhe kohët e fundit në Bashkinë e Peqinit ka edhe një fluks turistësh dhe ne po mundohemi që t'i orientojmë njerëzit drejt bujtinave, që të kenë mundësi edhe akomoduese dhe e cila sjell edhe të ardhura për Bashkinë e Peqinit. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zoti Tafani.

Arif Tafani:

Shumë shkurt, mbështetur vetëm në fakte dhe jo opinione, unë do thoja që kur folëm që para 2014-s nuk ka pasur fare shërbime, nuk është aspak e vërtetë që shërbimet janë ulur dhe nuk jepen me cilësi. Janë futur shërbime të reja dhe unë mendoj që jepen në bashkim të bashkuar me cilësi. Sa i përket burimeve njerëzore, rekrutimet bëhen mbas ligjit me procedurë. Kemi mungesa në disa profesione të caktuara si urbanist, arkitekt, ekspert gjisit, që vështirësisht pranojnë të vijnë në Bashki si Belsh, si bashki rurale. Strategjia e Bashkisë Belsh mbështetet në dy shtylla, që është turizmi, agroturizmi dhe bujqësia, pasi është një popullsi me rreth 80% fermere. Dhe në lidhje me distancat, për shkak të pozicionit, Belshi nuk e vuan pjesën e distancave. Fshati më i largët është rreth 16 kilometra, por duke qenë që nuk ka asnjë fshat i Belshit që nuk lidhet me asfalt me qendrën e ish-komunave apo me rrugën nacionale, distancat janë të shkurtura në minuta, deri në 15 minuta fshati më i largët. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zoti Disha.

Mariglen Disha:

Bashkia Librazhd, sa i përket të ardhurave, kemi krijuar një drejtori turizmi. Drejtorja e turizmit ka bërë një punë shumë të mirë me të gjitha, kemi hedhur në Google të gjitha resurset turistike, bujtinat, tani kemi hedhur dhe farmacitë që kemi në të gjithë territorin e

bashkisë, që turistët ta marrin informacionin direkt nga Google dhe shumë shpejt do dalim me një hartë online për të gjithë resurset turistike që ne kemi në territorin tonë. Kemi një rritje të numrit të turistëve dhe rreth 30 deri në 50% janë rritur në 2024-ën, në 2025-ën rreth 70% nga 2023-shi, por shpresojmë që në 2026-ën të kemi një rritje të numrit të vizitorëve që vijnë e vizitojnë Bashkinë e Libreshës. Kemi krijuar dy brigata me që merren me punët publike. Këto brigata janë specialistë që merren me trotuaret, me bordurat, me ndriçimet, me sistemimet e gjithë territorit të Bashkisë së Libreshës. Kemi investuar në të gjitha sheshet e njësive administrative, që ato vizitorë që vijnë mos të përqendrohen vetëm te një njësi administrative ose vetëm në qytet, por të përqendrohen dhe të shkojnë në të gjitha njësitë administrative. Drejtoria e turizmit, siç e thashë dhe pak më përpara, ka bërë një punë shumë të mirë dhe me promovimin që ne e kemi nxjerrur dhe e kemi për sa i përket bujtinave dhe resorteve që kemi ne në territorin tonë, duke i promovuar dhe duke reklamuar ato që të thithin sa më shumë turistë dhe të vizitojnë Bashkinë e Libreshës. Për sa i përket kapaciteteve të burimeve njerëzore, i kemi, nuk kemi kapacitetet, i kemi të gjitha, i kemi si Drejtoria e Urbanistikës, por dhe drejtoritë e tjera, i kemi me staf përkatës dhe të specializuar për sa i përket profesioneve të tyre. Nuk kemi shtuar numër të punonjësve, por ato që drejtori që kanë pasur më shumë sesa kapaciteti që ka drejtorja, janë ato që kanë dalë në pension, nuk i kemi zëvendësuar më, por po bëjmë investime në të gjitha rrugët kryesore të fshatrave, sepse paralelisht me rrugët kryesore të fshatrave, ne zhvillojmë dhe turizëm malor dhe kjo është një punë shumë e mirë që na janë afuar dhe kanë ardhur shumë që kanë pasur sigurë para shumë vitesh, tani kanë ardhur dhe kanë rindërtuar ose kanë bërë rikthim shtëpive të tyre dhe është shtuar numri i të larguarve që janë larguar para shumë vitesh. Kështu që kemi një shtim të këtyre familjeve që nuk e kanë gjetur veten kur kanë shkuar nëpër shtete të tjera, por kanë ardhur dhe kanë riparuar shtëpitë e tyre dhe janë sistemuar prapë në vendin e tyre. Tjetër, kemi një njësi, Njësia e Stblevës, me rikthimin e rrugës dhe me disa investime që kemi bërë në këtë njësi, kemi zhvilluar ndjeshëm zhvillimin e turizmit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zoti Disha. Se do kemi opsion tjetër, zoti Doka.

Florenc Doka:

Po, Bashkia e Cerrikës është me karakter bujqësor dhe pikërisht ky është sektor që është në rritje, realisht sektori bujqësor dhe për ta lidhur me pikën e dytë që ishte për potencialin, jemi pikërisht në këtë drejtim, sidomos një potencial i mirë që është për bashkinë, janë fabrikat e ullirit. Në një sipërfaqe prej 189 kilometrash katrorë, ne kemi rreth 18 fabrika që sot janë, minimumi i investimeve të tyre është rreth 500 mijë euro. Ajo që do mendoj unë që është dhe pjesë, ose duhet të jetë, është në gjykimin tuaj, pjesë e Komisionit për Reformë Territoriale, është rritja e kompetencave sa i përket rolit të bashkive në bashkimet privat-shtet. Sot, edhe nëse bashkia, sepse ne kemi zona shumë të lira territoriale për zhvillimin e bujqësisë, janë pronë e bashkisë, o do zgjedhin t'i japin me ankand ose do t'i lëmë zonat të lira, kur ne mund të marrim pjesë aktive si bashki apo ndërmarrjet me kapital 100% shtetëror të jenë aksionerë në bashkëpunimet privat-shtetërore. Sot, legjisllacioni nuk e lejon këtë gjë, ose të paktën nuk e kthen mbrapsht dhe të ardhurat tona majoritare janë taksat edhe ankandet që mund të veprojnë në këtë rast. Pra, kjo do ishte një ndihmë goxha e madhe për bashkitë, nëse një legjisllacion i tillë ndoshta do të duhej të shtyhej dhe nga ana juaj. Sa i përket lartësisë më të madhe, fshatin e kemi në 20 kilometra nga qendra e qytetit Cerrikë, që është qendra jonë. Sa i përket, thashë për pjesën e pagave në lidhje me kufijtë maksimal, do të thotë që numri i popullsisë që përcaktohet në VKM për pagat, përcakton nivelin minimal dhe maksimal, dhe ky numër popullsie, pra Cerriku,

Elbasani dhe të tjerët, kanë këto nivele që i kufizojnë pagat në nivelin e tyre maksimal dhe kjo ndikon tek burimet njerëzore, që do të thotë pra te burimet njerëzore, të cilat e kanë të vështira të vijnë me një pagë 140 mijë lekësh drejtori në Bashkinë e Cerrikës. Unë kam filluar me pagën 12 mijë e 500 lekë të reja si jurist, sot është 140 mijë lekë të reja, nuk është joshëse që një inxhinier apo një programues dhe një aplikues për programe europiane të vijë dhe të punojë në Bashkinë e Cerrikës. Sa i përket punësimeve, fokusin patjetër e kemi tek shërbimet dhe punësimet janë bërë në këtë drejtim më të shumta. Jemi në kërkim të dëshpëruar për aplikues programesh edhe në Bashkinë e Cerrikës, nëse njihni, është e gatshme që të vini, paga për specialistë është 70 mijë lekë, paga bazë, paga për përgjegjësit e sektorit të hapur dhe të gatshëm për këtë pjesë është 105 mijë lekë të reja.

Arbjan Mazniku:

Ëh, zoti Doka, faleminderit. Përpara se t'ia jap fjalën z. Zbuluk Bashi për pyetjet, ëh, do-unë mendoj që pyetjet e z. Gjinaso kishin një sërë çështjesh specifike. Do i kërkoja në fakt sekretariatit që ne t'i zbardhim ato, dhe kjo nuk vlen vetëm për këto pyetje, por edhe për rradhë të tjera të pyetjesh. Dhe më pas një pjesë të pyetjeve t'ia çojmë dhe me shkrim Bashkive, në mënyrë që të marrim një përgjigje, kur veçanërisht ato që kërkojnë të dhëna specifike, t'i marrim dhe t'i administrojmë eventualisht më pas edhe me shkrim si komision. Kështu që, në qoftë se është një pyetje që kërkon një informacion, një numër apo një, një, ëh, vlerësim, nëse nuk e dëgjojmë plotësisht përgjigjen këtu, të ruajmë drejtën që të çojmë, t'jua sjellim një kërkesë me shkrim dhe të marrim një përgjigje eventualisht për ta administruar. Zonja Bylykbashi.

Aulona Bylykbashi:

Faleminderit, kryetar. Nderuar kryetar Çarku Telbasan, ëh, pyetja ime është, ëh, në raport me përthithjen e ish-komunave nga Bashkit. Në 2015-ën, me realizimin e reformës administrative territoriale, Bashkit pati një proces të gjatë përthithje të ish-komunave, duke nisur që nga aspekti financiar, nga aspekti i burimeve njerëzore, nga aspekti i investimeve që ato kishin kryer e kështu në tërësi. Nisur nga kjo, unë dua të kem një përgjigje nga secila nga Bashkit se çfarë keni trashëguar ju nga ky proces në aspektin financiar, në aspektin logjistik dhe në aspektin e burimeve njerëzore, dhe si janë menaxhuar treguesit financiarë të secilës Bashki pas kësaj përthithje, duke u ndalur kryesisht në borxhet, detyrimet, në të ardhurat e veta në raport me të gjithë buxhetin dhe në shpenzimet e pagave në raport me buxhetin. Dhe pyetja tjetër është shumë shkurt: cilin nga funksionet, secila nga Bashkitë tuaja sot, has më shumë vështirësi për ta ushtruar dhe kush është arsyeja pse? Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Mendoj që të vijojmë në linjën nga zoti Belba te zoti Doka. Faleminderit.

Nuri Belba:

Në lidhje me formimin e Bashkisë së Madhe, duke u formuar nga tre njësitë, siç do jetë, ëh, ish-komunat kanë sjellë bilancet e tyre, të cilat u raportuan me thesarin dhe u futën në një sistem të përbashkët të Bashkisë, duke pasur me vete edhe shumë detyrime të palikuiduara, të cilat ishin duke filluar me energjinë elektrike e disa të tjera.

Arif Tafani:

Ëh, shtuar dhe kontratat ekzistuese rreth 176 milionë lekë. Bashkia Belsh deri në vitin 2019 ka qenë bashki në vështirësi financiare dhe sot jemi me një performancë të mirë financiare, pra jemi, kemi dalë nga, nga zona e kuqe. Në lidhje me, me, me logjistikën nuk kemi trashëguar asgjë nga komunat, zero. Sot kemi në çdo njësi zyrë me një ndalesë, ku shërbimi jepet, ëh, online, pra merren ankesat, kërkesat online. Ëh, të thoja në fakt, realisht numri i punonjësve nuk është rritur. Ajo që bën rritjen e numrit mendoj është shtimi i disa funksioneve të deleguara. Po themi që Belshi, ëh, ka 14 zarfikës që nuk i kishte. Ka mirëmbajtjen e rrugëve rurale që deri në 2015-in i ka pasur Këshilli i Çarkut, që na ka transferuar 15 punëtorë. 33 punonjës janë të arsimit parashkollor dhe vazhdojnë me ujitje, kullimin, pyjet, emergjencat civile e shumë shërbime të tjera që nuk kishim, po themi, trajtimi i rasteve të dhunës i grave të dhunuar apo i fëmijëve të dhunuar e me radhë. Ëh, funksione do të themi që jo nuk i realizojmë, por ka akoma punë për të bërë. Unë do përmendja, dakord, unë do përmendja, ëh, pastrimin e kanaleve kulluese dhe ujitësit. Duhet një flotë më e madhe dhe, dhe mjete më shumë dhe emergjencat civile për të përballuar situatat, sidomos të zjarreve, por edhe përmbytjet.

Arbjan Mazniku:

Po, zoti Disha, fjala për ju.

Mariglen Disha:

Ëh, përshëndetje. Ëh, përsa i përket pyetjes së parë, ëh, me borxhet që ka pasur Bashkia e Librazhdit, ëh, ëh, si kolegu im i pronësit dhe ne kemi pasur rreth 16 milionë lekë të reja vetëm përsa i përket energjisë elektrike nga ish-komunat. Ëh, kemi lidhur një marrëveshje me USHE-në dhe atë po e paguajmë pjesë-pjesë. Ëh, në lidhje me shërbimin social dhe aty kemi pasur probleme. Ëh, me personat me aftësi ndryshe kemi pasur goxha probleme, ku ne bëmë të mundur rikonstrukcionin e ish-Gjykatës dhe Prokurorisë, që krijuam një qendër multifunksionale, që ato persona me aftësi ndryshe të kenë një qendër të tyre për të, për t'i shërbyer, si duke filluar nga fizioterapistë, logopedistë, ëh, dhe kemi vënë në dispozicion dhe një makinë që të shkojnë t'i bëjnë shërbimet e shtëpive të këtyre personave që janë me aftësi ndryshe. Ëh, probleme të tjera nuk kemi pasur. Ëh, terreni dihet që ne kemi terren malor dhe rrugët kryesore të fshatrave i kemi pasur prioritet dhe jemi përqendruar që t'i karikojmë dhe t'i mbajmë sa më të mira, që mos kenë probleme me rrugët kryesore. Me shirat e fundit që ranë tani, patëm në disa fshatra patëm probleme me rrugët kryesore, por grupi jonë i punës që e ngritëm në kohë rekord u hapën dhe sot kemi rrugë të aksesueshme në të gjithë territorin e Bashkisë së Librazhdit. Faleminderit.

Luçiano Boçi:

Po, zoti Doka, fjala për ju.

Florenc Doka:

Ëh, përsa i përket problematikave apo trashëgimit që kemi pasur nga komunat, ëh, borxhe kryesisht në lidhje me prokurimet që komunat kanë pasur. Në sa i përket logjistikës dhe territorit, rrugë të asfaltuara, mungesë mjetesh, sidomos për pjesën që ne na takon, që është pjesa e bujqësisë, sot aktualisht kemi vetëm tre, kemi tre mjete gërmimi të cilat i dedikojmë punës vetëm për kanalet ujitëse dhe vaditëse që janë për zonën tonë të rëndësishme. Sa i përket problematikave ku hasim vështirësi, është strehimi social. Ëh, sidomos qyteti i Cërisë ka një problematikë të tillë, sado që është bërë një punë e mirë

dhe çdo vit neve, ëh, rikonstruktojmë rreth 50 banesa private, na duhet një model i ri i strehimit social. Para disa kohësh kemi bërë një model të tillë të, të shtëpive sociale siç ka modeli italian, shtëpitë sociale atje strehojnë banorët dhe ata paguajnë një pagesë qiraje. Ajo që kërkohet dhe që i shërben sidomos qytetit të Cërisë do ishte e nevojshme ndërtimi i disa pallateve, sepse sot kemi problematika të tilla që të shndërrohen në banesa sociale me një pagesë të ulët qiraje. Kjo do ishte ndihma më e madhe që gjithsesi Bashkia e ka pamundur sot për t'i financuar e vetme si, si investim.

Luçiano Boçi:

Po, atëherë ja kalojmë fjalën deputetëve për pyetje. Zoti Bozdo, fjala për ju. Apo ka një koment nga zonja Bylykbashi? Jo? Atëherë... Jo, jo, jo, jo. Jo. Po, për ty fjala, Ramadan. Vazhdo tashi, Ramadan. Fjala për ty.

Ramadan Likaj:

Faleminderit, bashkëkryetar, të nderuar kolegë. Sigurisht që duhet me qenë pak më, më ndryshe me kryetarët e bashkive. Ju falënderojmë që jeni këtu. Ne nuk kena tendenca që të bëjmë pyetje që realisht nuk i shërbejnë qytetarëve. Ne kemi interesa të gjithë së bashku që nga ju, pyetjet tona të shkojnë në shërbimin edhe drejtpërdrejt të shkojnë te qytetari. Në qoftë se ju, gjithsecili nga ju, bëhatë një ekspozë para 2014-s dhe pas 2014-s me miratimin e kësaj reforme. Në qoftë se ne do të kishim pasur sukses, ne nuk do të ishim këtu sot. Por ne mendojmë të gjithë së bashku se diçka ka çaluar gjatë këtyre 10 viteve, 12 viteve. Ndaj them që unë u kuptoj ju, se në qoftë se ne nuk jemi këtu, bëjmë bashkëbisedim me ju, ju do flisni krejt ndryshe. Sot qasja është e qartë. Çdo bashki e juaja ka pasur edhe komunat të ngjitur. Pyetja ime është drejtpërdrejtë për ju. Sa punonjës kanë pasur komunat edhe bashkitë para 2014-s edhe sa ka sot Bashkia? Si ishin të ardhurat e komunave para 2014-s bashkë me Bashkinë sot si është kryesore edhe si janë sot? Dhe pyetja e dytë: A mendoni ju, se janë dy qasje, po themi, mazhoranca kërkon që të zvogëlojë numrin e bashkive, kjo dihet. Opozita kërkon rritjen e numrit të bashkive për arsye se shërbimi të jenë sa më afër shërbimit të qytetarit. Po në qoftë se sot ju pyetja është kjo: Janë 61 bashki, mazhoranca kërkon për me ul këtë numër të bashkisë. Sigurisht që bashkitë tuaja, bashkitë tuaja, pjesa më e madhe do të ikin. Edhe unë nuk mendoj kurrë që ju të thoni këtë, të bëni këtë qasje. Se ka kryetarë bashkie që keni mandatin e parë, të dytë edhe pretendoni për mandat të tretë. Po në qoftë se Bashkia juaj mbyllet nesër, ik, se do t'i kalojnë, po thonë prej asaj. Do të bashkangjitet Librazhdit, sigurisht. Belshi, si është një zonë shumë bujqësore, sot e njoh edhe nga afër Belshin, kam bërë me Belshin. Do të ikun. Elbasani që nuk është i pranishëm këtu, si është Bashkia më e madhe që realisht duhet të ishte, por për arsye pune, t'u tha nga Mazniku, se nuk ka nevojë të jetë këtu, se dihet se Bashkia e Elbasanit do të jenë edhe do vazhdojnë të rriset, të rritet Bashkia e Elbasanit në qasjen gjithmonë të mazhorancës. Po ashtu edhe Peqini, po ashtu edhe Cëriku. Pra, ne jemi në një situatë që unë u kuptoj shumë mirë si një të kontraktuar sot këtu, se veç ndryshim, se kryetarë bashkie të më kenë edhe dhënë. Në qoftë se unë jam pyet në 2014-n për këtë reformë, kom pasur qasjen time në atë kohë edhe e kom pasur krejtësisht të pastër, duke pasur parasysht territorin, shtrirjen e territorit dhe shërbimin te qytetari. Ndaj them që çfarëdolloj pyetjesh t'u bëjmë ne ju sot, absolutisht ne nuk marrim përgjigje si i vlejnjë këtij komisioni. Ti nuk bindun për këtë punë. Jashtë kuinteve kam bindje se ta po marr përgjigjen nga ju. Ndaj them, zoti kryetar, është e kotë ne t'i lollim, t'i lollim kryetarët e bashkive. Përgjigje ti nuk bindun se ne nuk marrim. Thjesht ata bëjnë një ekspozë: shërbimet janë më mirë, veprimet janë, çdo veprim sot qytetari e merr shërbimin online. Ne këto a thu se ne vijmë nga një vend tjetër edhe nuk i dimë se si shërbehet edhe si është situata. Unë si ish-kryetar bashkie të nderuar, kryetar, kanë

qenë pesë komuna edhe një bashki. Dakord? Në kohën që unë isha kryetar i bashkisë. Sigurisht që sot ato pesë komuna janë të gjithë bashkisë ku isha kryetar i bashkisë. Tani, në qoftë se unë duhet të jem i drejtpërdrejtë me ju, edhe me qytetarët shqiptarë, absolutisht shërbimet nuk janë ato që janë qenë para vitit 2014. Në Malësinë e Madhe, komunat, pesë komuna edhe bashkia kishin 285 punonjës, duke përfshirë komplet edhe pjesën e shërbimeve të brendshme. Sot Bashkia e Malësisë së Madhe, që po dal konkretisht se këto janë, këto janë gjërat kryesore, ne këto dy t'i themi, Bashkia e Malësisë së Madhe sot, për mos duhet të jem korrekt, mund të ketë dyfishuar këtë numër, mund të jenë rreth 540 ose pak më shumë punonjës. Atëherë lind pyetja: Si janë shërbimet ndaj qytetarit? A janë më të mira punësia? Në qoftë se unë sot them: Në Malësinë e Madhe, po kjo është në përgjithë Shqipëri, nuk po marr shembull Malësinë e Madhe, sot fshatrat i ke të braktisura. Nga kush? Pra, edhe nga shërbimet. Se në atë kohë të gjithë kryetarët e komunave ishin të interesuar maksimalisht për me marrë sa më shumë fonde për të shërbyer qytetarët me rrugë, me shërbimet e përditshme. Kurse sot është krejt ndryshe. Pra ne këtë duhet t'i themi. Pra ne nuk kemi asnjë lloj tendence që t'u bëjmë pyetje ju, edhe ju me të drejtë, me të drejtë jepni ato përgjigje. Kjo nuk është një ndërhyrje si debatin këtë reformë për t'i shërbyer një anës së palës. Absolutisht jo. Kjo është një reformë që duhet t'u shërbejë qytetarëve shqiptarë për të ardhmen. Dhe kjo është tanesenca jonë. Ndaj them që një pjesë e madhe nga ju sigurisht që keni shumë dëshirë për të thënë atë që është e vërteta, por nuk mund ta theni sot. Nuk mundeni me thanë. Se kështu janë dhënë orientimet, kështu janë orientimet. Se në rastin konkret, ne në këtë moment edhe ju bashkoheni me ne, biles shumë më shumë ne jemi sot ju kontribut se mund të japim ne. Se ju jeni drejtpërdrejtë me qytetarin. Kurrkush nuk mund ta dijë më mirë, se çdo kryetar bashkie të dijë më mirë se kurrkush tjetër se ku janë problemet edhe hallet e çdo qytetari. Kurse dje, para 2014-s, një kryetar komune dhe një kryetar bashkie për çdo lloj rasti që do të kishte brenda komunitetit të vet, ai do merrte pjesë. Sot është e pamojtur një kryetar bashkie të marrin pjesë për halle, probleme kudo, çdo lloj fshati. Kurse dje po, kryetari i komunës e bënte atë punë, kryetari i bashkisë po ashtu. Sot është e pamojtur. Jo se nuk ka dëshirë, është nuk, nuk i del koha, nuk ka ku me pasë kohën. Ndaj them që unë bëra një ekspozitë të përgjithshme për të shkuar te realiteti i realitetit. Ndaj them që çdo lloj pyetje, çdo lloj përgjigje e juaja është shumë e vyer, jo për sot, për të ardhmen. Se në fund e fundit gjithë që jemi këtu, ne nuk kemi marrë gjëra me tapi, as do të kemi gjëra me tapi. Por kjo gjë, si themi ne sot këtu, u shërben qytetarëve shqiptarë për të ardhmen. Faleminderit.

Luçiano Boçi:

Faleminderit zoti Lika, fjala për kryetarët e bashkive. Po, e bëri pyetjen në fillim, e bëri pyetjen në fillim për çështjen e numrit të punonjësve. E bëri pyetjen. Jo, jo, e bëri pyetjen, pastaj bëri parashtrimin. Po tani... Po, jo, po e qartësoj, e bëri pyetjen, jo, e bëri pyetjen, po zvuri pikë çuditëzen. Po tani e bëri pyetjen, ato të japin përgjigjen. Po tani... Po në parashtrim pyetjen e ki... Po.

Tani formulojeni si keni dëshiruar. Atëherë i formuloj pyetjen e natës...

I bëjmë kontraktuar, ata ja dhanë përgjigjen premionin, e kanë dhënë kështu si...

Dhe një herë tjetër, edhe një herë tjetër, jo, s'ka rëndësi mos, mos ndërhyjni kot, domethënë midis njëri-tjetrit.

Luçiano Boçi:

Së pari, o Ramadan, ja një minutë. Ramadan, nuk ne vendosëm një standard, foli deputeti, foli deputeti, bëri pyetje në parashtrimin e tij, i tha edhe në formë parashtrimi dhe në formë pyetjesh. Nuk patë asnjë fyerje nga ana e deputetit, madje unë mendoj që tregoi solidaritet plot me pozicionin që kanë kryetarët e bashkive. Po, sigurisht, s'patë asnjë lloj fyerje. Kështu që secili prej tyre të japi një përgjigje për numrin e punonjësve. Si kanë qenë në rast kur kanë qenë të ndara, të organizuara në komuna, apo në bashki kur ka qenë bashki, dhe si janë sot kur janë të bashkuara. Kaq. Kanë më shumë apo kanë më pak? Kjo është ajo kërkesa që paraqiti zoti Lika. Faleminderit. Po, zoti Maci.

Bukurosh Maçi:

I nderuar deputet, të garantoj që unë si kryetar i Bashkisë së Peqinit jam shumë i sinqertë dhe këtu them mendimet e mia. Një kryetar bashkie është i politizuar në kohën e fushatës. Një kryetar bashkie, në këtë moment që jemi, nuk shikojmë ngjyra politike. Dhe mua më vjen keq sepse ju përdorët edhe sarkazëm këtu duke na thënë që ju mendoni ndryshe, ndërsa unë po ju garantoj që nuk mendoj ndryshe. Unë e thashë me bindje të plotë që ato që thashë dhe më përpara në fjalimin tim disa herë dhe mendoj që Bashkia e Peqinit po duhet të rrijë. Duhet të rrijë Bashkia e Peqinit, tregova dhe arsyet pse duhet të rrijë që mos i kthehem prapë, ndërsa me performancën e ish-komunave dhe sot që territorin e menaxhon Bashkia e Peqinit, që është një, nuk ka lidhje, të garantoj për këtë dhe, dhe në qoftë se do mendimin tim real, unë këtë mendim po e them mbas tre vjetësh si kryetar i Bashkisë së Peqinit, se po të isha në fillimet e mia, mbase nuk do flisja me këtë optimizëm, ndërsa sot flas sepse Bashkia e Peqinit ka ndryshuar dhe po punohet në të gjitha sektorët dhe shërbimi ndaj qytetarëve është shumë herë më i mirë. Dhe ato punë që nuk i bën dot një njësi administrative apo një komunë, në me këtë lloj bashkimi ka më shumë forcë, më shumë të ardhura, më shumë përgjegjshmëri për të marrë iniciativa në shërbim të qytetarëve. Faleminderit.

Luçiano Boçi:

Po, zoti Tafani, po.

Arif Tafani:

Fakt unë e ndgjova me vëmendje, ishte deputet, ishte kryetarin, ish-kolegun tonë dhe nga gjithë ajo parashtrim kam shënuar vetëm një pyetje. Pjesa tjetër ishin aludime dhe, dhe qarje-hallje jona. Sa i përket numrit të punonjësve, sot Belshit ka 235 punonjës dhe ka trashëguar nga 2014-ta 150. Këta me siguri me shoqërore, sepse ka pasur dhe çudira në ish-komunat, mbaheshin punëtorë pa siguri me shoqërore, po themi roje nate e ku di unë. Dhe po të heqim këtu shërbimet dhe funksionet e deleguara, zjarrfikësen, Bordin e Kullimit, rrugët rurale të transferuara nga Qarku, pyjet, kullotat, arsimin parashkollor, qendrën sociale të trajtimit të moshës tre, etj., ne kemi punësuar sot 99 dhe 235, të heqim 39, shkojmë në 126, mos gaboj. Pra, nuk kemi rritje të numrit të punonjësve, por kemi ulje. Sot, mbas censusit, Belshit ka 13 nëpunës, punonjës për 1000 banorë, sipas zgjedhjeve civile, shtatë. Në lidhje me të ardhurat, që ishte nënpyetja e dytë, ne e kemi gjetur pesë njësi me 20 milionë lekë në vit dhe në vitin 2025 kemi arritur të mbledhim 82 milionë lekë të ardhura.

Luçiano Boçi:

Faleminderit. Po, zoti Disha, fjala për ju.

Mariglen Disha:

Në lidhje me numrin e punonjësve të Bashkisë së Dibrësht, sot ne kemi 456 punonjës. Kuptohet që ish-kolegu jonë, kur ka qenë kryetar komune, nuk besoj që të ketë pasur si zyrë për shërbimin social, si zyrë për urbanistikën, si zyrë për MNZ-në, zjarrfikësen, por edhe kur ka qenë dhe komune, po. Por mendoj që nuk ke pasur as zyrë për diasporën, as zyrë për projektet e huaja, as zyrë për turizmin, kështu që sot ne, sot ne i kemi këto dhe numri kuptohet që numri është 456, por të gjithë stafi është në krye të detyrës dhe qytetarët marrin shërbimin e duhur. Faleminderit.

Mariglen Disha:

Urdhëro. Si?

Ramadan Likaj:

Sa ishte para reformës dhe sa është tani?

Mariglen Disha:

Nuk kam qenë më para, unë dy vite, dhjetë muaj kam, nuk e di.

Florenc Doka:

Atëherë, sa i përket numrit, nëse duhet jua sjellim me shkrim, por duke qenë se kam qenë pjesë e transferimit të administratës nga komunat tek bashkia, numri është më i vogël sot se çka ka qenë më përpara. Shërbimet sot janë rritur, arsimiti parashkollor nuk ka qenë pjesë e bashkive, neve kemi 65 të tillë. Zjarrfikësja nuk ka qenë pjesë e bashkive, kemi 17 të tillë. Bordi i Kullimit nuk ka qenë pjesë e bashkive, kemi 10 të tillë dhe numri total i bashkive sot është 289 i Bashkisë së Sërrikë, duke futur këtu dhe mirëmbajtjen që është pjesë e vetë bashkisë dhe jo ndërmarrje më vete. Pra, si numër, këtë e them me siguri, por gjithsesi jua sjellim edhe me shifra sa ka qenë numri, sa është, është, është ulur. Sa i përket të ardhurave, në Bashkinë e Sërrikë të ardhurat janë në trefishuar. Me siguri janë rritur edhe mundësitë, pra mundësitë me licencionin përkatës që neve na janë krijuar dhe mundësi tjera vjelje të ardhurave. Ne sot kemi 120 milionë lekë të ardhura në vit. Pak janë dhe këto, si normalisht nuk na, nuk na mjaftojnë, por gjithsesi të ardhurat në rastin konkret në lidhje me komunat që kanë qenë janë trefish më të larta. Për Bashkinë e Cërrik.

Luçiano Boçi:

Ëh, ëh, ja kalojmë fjalën zotit Sara. Po, zoti Belba, po ngaqë ju e latë, mendova që s'kishit përgjigje, se zakonisht e nisnit ju edhe.

Nuri Belba:

Mirë, faleminderit për pyetjen dhe është e drejtë që si ime është kolegut tonë. Përsa i përket pjesës së numrit të punonjësve që kanë pasur njësi para 2014-s, në Pranja si Rajca, Quhësja dhe Stravaj ka qenë një numër ke 286 punonjës, por duke parë sot që jemi në kushte tjera, ku kemi marrë shumë funksione, ne vetëm aparatit administrativ kemi 72 veta, që paguajmë, i kemi me stacën punësi ose me kontratë, ndërsa gjithë pjesa tjetër janë punonjës të cilët janë me kontratë njëvjeçare dhe janë punonjës shërbimesh. Përsa i përket të ardhurave, në 2014 nga qenë 29 milionë e 500, sot janë 96 milionë lekë.

Me fjalë, është trefishuar, siç tha edhe parafolësi, por ka ndikuar edhe pjesa, disa të ardhura të cilat më përpara s'kanë qenë, janë shtuar, por them që menaxhimi është bërë më mirë se çka ka qenë përpara, për arsye se... Kush? Niveli. Niveli, tani nivelet janë sipas disa vendimeve të qeverisë, të cilat ju... Një, tani unë po them, Njësia e Qugës ka qenë njësia më e madhe, ka mbledhur gjithsej 3.2 milionë në vit. Ndërsa Rrajca ka pasur 3.8. Qyteti ka pasur 2.4, kështu që...

Luçiano Boçi:

Zoti Belba, faleminderit. Atëherë, zoti Bozo, fjala për ty. Pa më eno tashi, se po s'do e bëjmë kështu, tashi, ju lini, unë s'di këtë radhë më... Fjala për ju, domethënë, tani, po nuk do më burrë...

Arif Tafani:

I nderuar deputet, në 2014 nuk ka pasur tarifa pastrimi, se këto janë tarifat, pastrim, gjelbërim, ndriçim. Këto mbledhim ne. Në komuna zero, më gjeni një komunë, zero. Në komuna...

Luçiano Boçi:

Bledion.

Luçiano Boçi:

Bledion, o Bledion.

Arif Tafani:

Po s'kishin më, nuk, nuk realizohej shërbimi. Ore, nuk, duke mos pasur shërbim të menaxhimit të mbetjeve dhe pastrimit, nuk, nuk kishte tarifë, nuk mblidhej, zero, se nuk, nuk jepej shërbimi.

Bledion Nallbati:

Më fal, o, o kryetar, o kryetar... O kryetar, kam një pyetje shumë të thjeshtë për të gjithë ju. Kam një pyetje për të thjeshtë, shumë të thjeshtë për të gjithë ju. E para janë tarifat, tarifat sigurisht që kanë qenë, nuk mund të kenë qenë atje ku s'ka pasur shërbim. Po... Atje ku s'ka pasur shërbim mund të mos ketë pasur tarifë, po tarifat kanë qenë, tarifa e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit, të gjitha këto kanë qenë tarifa. Megjithatë, pyetja është shumë e thjeshtë: nga viti 2015, tarifa e pastrimit në Bashkinë Belça apo kudo, te të gjitha bashkitë tuaja, sa ka qenë në 2015-ën, sa është sot? Është rritur apo jo? Kjo është pyetja, sepse thatë janë rritur buxhetet. Ka dy arsye që janë rritur buxhetet. Jo vetëm shtimi i atyre tarifave, po ka dhe, arsyeja kryesore është rritja e vlerës së këtyre tarifave, rritja e masës së këtyre tarifave. Dhe ti mund, gjithsecili mund të thotë: sa e ka pasur 2015-ën tarifën e pastrimit për familje në fshat apo në qytet, sa e ka sot? Që të shohim ka ndikuar ndonjë gjë kjo në rritjen e buxheteve apo jo? Sepse ju thoni vetëm këto që janë, që, që është rritur buxheti se janë bashkuar bashkitë. Është rritur buxheti se është rritur bara mbi çdo familje. Është, është rritur bara mbi çdo familje me rritjen e tarifës të pastrimit, gjelbërimit dhe çdo tarife tjetër nga bashkia.

Arif Tafani:

Atëherë, atëherë një korrëgjim në shprehje, ideja ishte që nuk operonin me tarifa sepse nuk kishte shërbim. Ekzistonin ligj, patjetër që ekzistonte, pra ekziston. Po flasim për ish-komunat, pra. Atëherë, shërbimi i menaxhimit të mbetjeve, marrim tarifën e pastrimit, ka filluar në dhjetor të 2015-ës, është rritur në të gjitha fshatrat dhe ka një rritje nga 2015 në 2025-ën me 20%. Belshi, ëh, në Belsh, Belshi për frymë, Belshi, Belshi për frymë e ka pasur 1000 lekë në muaj të vjetra, 100 lekë, e ka çuar në 120 lekë. Pra kaq është rritja për, për 10 vite. Ëh, unë mendoj që rritja e të ardhurave me katërfish nga viti 2014 ka ardhur për, ëh, arsye të mirëmenaxhimit dhe, dhe të mbledhjes së taksave. Njerëzit kanë kuptuar dhe kanë filluar të paguajnë. Kemi problem në, në taksën e pasurisë, ëh, por rritja është e evidente.

Luçiano Boçi:

Atëherë, fjala për zotin, zotin Mziu. Ëh, na falni zonja Koçeku, po ngaqë jemi në mbledhje grupi, ne duhet të ezaurojmë pyetjet. E kemi në ora një, prandaj ja kalova dhe fjalën zotit Mziu. Pardon. Po, zotin Mziu, fjala për ju.

Xhelal Mziu:

Faleminderit, kryetar. Në fakt, ëh, mbaj mend që në 2014 kishte dy, ëh, kauza kryesore për pushtetin vendor. Së pari ishte kursimi që duhej t'i bënim për shkak të ekonomisë së shkallës, duke kaluar nga 373 njësi në gjerdhëni, që do t'i kursenim buxhetit të shtetit diku te 8 milion euro. Dhe në fakt, jo vetëm që nuk është kursie, por përkundrazi është, është 2.5 herë më shumë numri i administratës, e për pasojë fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore ka pësuar një rritje të ndjeshme. Pra çfarë do të thotë që është rritur, të paktën fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore është rritur, ëh, pothuajse me 15% më shumë, dhe ndërkohë po prapë treguesi më kryesor, sepse qytetarët kanë nevojë për dy gjëra: për të patur infrastrukturë, pra investime, dhe për të patur, po themi, ëh, shërbime. Po ju kujtoj në aspektin e përgjithshëm, kur kishim 373 njësi vendore, fondi i investimeve zënte 37.5% të buxhetit të 373 njësi vendore. Sot është 18%. Pra kur kemi më pak bashki, ka më pak investime. Përshkruar sepse disa nga kolegët e mi bënë pyetje për të punësuarit. Unë po ju jap një referencë sipas statistikave të Instatit dhe të Ministrisë së Financave deri në 2024-ën, se 2025-ën akoma nuk na e kanë publikuar. Dhe unë po ju them dy nga bashkitë që ju jeni aty, siç është Cerriku dhe Librazhdi, janë një ndër dy bashkitë që kanë patur rritjen më të vogël të fondit të pagave. Por sidoqoftë, fondi i pagave nga viti 2015 deri në vitin 2024 është rritur dy herë më shumë për Cerrikun dhe për Librazhdin, ndërsa për të gjitha bashkitë e tjera, Pëçenin, Prenjasin, Belshin dhe Gramshin, është rritur tre herë më shumë. Statistikat, po desha t'ju vendos në dispozicion, të temetuara nga Ministria e Financave dhe nga Instat. Pra ajo që ju thoni është zvogëluar, është gënjeshtër. Atë që thoni ju fondi është më pak, është gënjeshtër. Tre herë më shumë të gjitha bashkitë, përjashtuar Librazhdin dhe Cerrikut. Ëh, një tjetër element shumë i rëndësishëm është, ka qenë kadastra urbane, që do të kishte një revolucion, do t'i kalojë pushtetit vendor dhe për pasojë do rritej taksat e pronës, sepse ne jemi vendi i fundit në rajon dhe nëse ka dikush që duhet ta mbledhë, është pushteti vendor. Ju nuk keni kompetencë. A keni zyra ju të kadastra urbane? Asnjë. Kush prej jush ka? Jo vetëm që s'ka, por është gjithë kadastra ka ardhur në Tiranë. Ju, edhe kur doni të ndërtoni një institucion publik, ju duhet t'i drejtoheni Ministrisë përkatëse për t'ju dhënë leje tek bashkia juaj për të ndërtuar, sepse nuk e keni kompetencë. Të ardhurat që ju krijoni nga ky sektor janë minimaliste. Dhe a do të ishit ju dakord që t'i kishit këto zyra? Apo jo? A do të ishit ju dakord, po themi, që të kishit vetëm 1% të GDP-së në fillim të vitit, në dallim nga të gjitha vendet e tjera të rajonit që e kanë me 2% apo me 3%? Jeni apo s'jeni dakord? Pavarësisht se ju jeni, keni përballë përfaqësuesin politik dhe keni frikë, sepse tani jeni

dhe në prag të zgjedhjeve të kandidimit dhe kush është ai që do shprehej? A do të ishit, a është zgjidhje normale, sepse ju jeni pothuajse bashki, sepse ai Elbasani nuk ka ardhur. E dini pse s'ka ardhur ai Elbasani? Është bashkia, një ndër bashkitë më të këqija të Shqipërisë. 52% deri në 54% të buxhetit të saj e shpenzon për pagat e sigurimeve shoqërore dhe ekonomia e shkallës, si ju thoni, ose më saktë që thotë zoti Mazniku. Pra, nëse ka një bashki, po themi, që ka sukses, është Prenjasi, është Gramshi, është dhe Librazhdi, por nëse krahasoheni ju me Elbasanin, është skandaloze. Elbasani edhe njëherë, më shumë sesa 52% deri në 54% e dërgon për pagat e sigurimeve shoqërore dhe nuk e dërgon tek qytetarët, sepse i duhen patronazhistët. Më shumë sesa 50% prej tyre jam i sigurt që nuk e dinë kush është vendi i punës. Nuk kanë as kompjuter, nuk kanë as karrike, nuk kanë as zyrë, por nuk kanë edhe një vegël pune për të punuar diku në terren. Pra çfarë do të thotë që pushteti vendor është kthyer në një shtojcë të partisë në shtet, partisë shtet, se kemi një parti, një shtet. Një tjetër element është, të gjitha vendet e rajonit dhe të Evropës përfitojnë nga taksat kombëtare. A përfiton ju? A jeni të kënaqur? Absolutisht jemi të fundit e rajonit dhe të Evropës. Asnjë lekë s'marrim dhe një rënjë që jepet është simbolike me 0.0005% e asaj xhiro që mund të bëhet, shkon tek ato. Tjetër, ju jeni bashki të cilët nuk jeni bashki bregdetare, nuk jeni bashki qendër qyteti, siç është Elbasani, dhe a merrni fond kontingjence për të balancuar të ardhurat? Siç operohet në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, ka një fond balancimi. Pra, nuk mund të trajtohet si bashkia, po themi, e Durrësit dhe si bashkia, po themi, e Gramshit, apo si bashkia e Elbasanit, apo dikush tjetër, sepse natyrisht bashkitë bregdetare, bashkitë qendër, Qarku, kanë më shumë biznese, kanë më shumë të ardhura. E në fakt, Evropa ka bërë një tjetër shpikje: jep fondin e balancimit. Të gjitha ato bashki të cilët nuk kanë kapacitete financiare, i jepet 1% të paktën nga buxheti i shtetit që ia jep këtyre bashkive të cilat nuk kanë kapacitete. Ku mund të kërkosh kapacitete në Gramsh? Ku mund të kërkosh kapacitete, po themi, në Prenjas? Sepse aq kapacitete ka aty dhe ndërkohë jepet, me të vetmin kusht që bashkitë të mos kthehen në elementë të cilët mos e vjelin taksat lokale dhe i jepet. A do ishit ju dakord që ta kishit? Pra ky është zëri që ju duhet të ngrini. Po t'i shohësh të gjitha bashkitë të cilat kanë një performancë më të mirë, janë bashki të cilat kanë më pak njësi vendore. Mbi fjala, po t'i shohësh, Pëçeni është me 6 njësi, Cerriku me 4 njësi, Prenjasi me 4 njësi, Belshi me 5 njësi. Pra janë të suksesshme ato që janë me më pak njësi. Po më thoni mua çfarë mund të bëjë? Po marr Dibrën që ka 15 njësi. Çfarë mund të bëjë dikush tjetër që ka disa njësi dhe i duhen me kilometra të tërë? Se ne ngatërrojmë atë centralizimin dhe decentralizimin. Kur ne jemi afër qytetarëve, i shërbejmë atyre. Kur ne e kemi me kilometra të tërë për të ardhur, nuk i shërbejmë. Kështu që edhe kjo është një tjetër shqetësim dhe do të doja që ju të kishit një reagim, të kishit një reagim, sepse nuk besoj që Prenjasit do të ishte mirë që t'i bashkohej Librazhdit, apo t'i bashkohej Elbasanit, apo që Gramshit t'i bashkohej Elbasanit, apo që Pëçeni dhe Belshi t'i bashkoheshin Elbasanit. Do të ishte vrasëtorë për ato qytetarë. Ju e keni parë se si kanë ngelur tokat dje, ju e keni parë se shkolla pafund mbyllën dhe pastaj, kur ngelen shumë pak nxënës, kthehen në katër klasa me një mësues e për pasojë, pastaj prindërit e fëmijëve detyrohen ose të vijnë në Tiranë, ose të shkojnë jashtë Shqipërisë dhe të ngelet kjo situatë kaotike. Do të ishte zgjidhje, mbi fjala, Elbasanit, të paktën si bashkia e Elbasanit, të kishte dhe tre njësi të tjera dhe të paktën disa komunikime që kemi patur me ish-kryetarë apo me qytetarë të asaj do të kërkonin që të kishte një bashki, siç është zona e Shpatit, apo Brada Sheshit, apo e Lunikut, që do të ishin vërtetë një histori suksesi dhe paratë e tyre të mos shkonin 54% për pagat e sigurimeve shoqërore. Kështu që, nëse ne po bëjmë dhe jemi në një situatë të kundërt me qeverinë, jemi sepse ne duam që Shqipëria të shkojë në Bashkimin Evropian me standarde. Decentralizimi i pushtetit vendor është numër njësi. Ofrimi i shërbimeve pranë qytetarëve është numër njësi. Delegimi i kompetencave është numër njësi. Ju jeni vetë dëshmitarë. Në vitin 2015, 100% e

ujësjellësave kaluan tek bashkitë. Ku janë sot ujësjellësat? Kush ju pyeti ju? Vjen direkt drejtori nga Ministria dhe madje i ka bërë rajonale, tani i ka bërë dhe kombëtare prodhimin e saj dhe s'keni asnjë lloj lidhje. Pra, me ato shërbime të cilat i shkojnë qytetarëve. Në vendet e tjera të rajonit, po themi, arsimin parauniversitar e kanë bashkitë. Qarkullimin e qytetit e kanë bashkitë. Kadastrën urbane e kanë bashkitë. Kështu që ngrini zërin, sepse nuk ka lidhje kjo se do shkojë tek Podoja apo do shkojë tek Posoja. Ju keni marrë një mandat, ju dhe ne duhet të kemi referencë vetëm te Bashkimi Evropian dhe duhet të ngrini zërin dhe të mos bëheni thjesht fasadë për të mos i prishur oreksin, po themi, partisë apo dikujt tjetër. Faleminderit!

Arbjan Mazniku:

Faleminderit! T'i japim fjalën nga një koment përfundimtar, meqenëse do ta mbyllim mbledhjen secilit prej kryetarëve, një përmbledhje, në mënyrë që... Po, kisha vetëm shqetësimin se zoti Boç më tha që... Mund të përgjigjem? Po, mund ta bëjë dhe Mariana pyetjen dhe pastaj ne jemi në limit kohës. Po, mund ta bësh. Bëje dhe ti pyetjen dhe pastaj i përmbledhim të gjitha në një përgjigje. Bëni pyetjen!

Marjana Koçeku:

Faleminderit! Atëherë, pyetja ime për ju është se çfarë metode ose strategjie mendoni se duhet të ndiqet nga grupi i reformës territoriale, me qëllim zbutjen e pabarazive territoriale midis qendrave kryesore, pra qyteteve edhe njësive/zonave më periferike, si në aspektin e investimeve publike, qoftë financave edhe burimeve njerëzore? Pra, më shumë kompetenca njësive administrative, a do të ishte më e frytshme për një qeverisje vendore më të mirë? Si mendoni ju? Faleminderit!

Arbjan Mazniku:

Faleminderit! Unë mendoj që për të përmbyllur këtë seancë, t'i japim fjalën secilit prej kryetarëve për një përmbledhëse dhe të pyetjeve të zotit Mziu dhe pyetjeve të dy minuta për secilin.

Nuri Belba:

Atëherë, po fillojmë nga zonja. Besoj që për sa i përket pjesës së dhënies së kompetencave të njësive administrative, unë besoj që Qarku deri tani nuk ka kryer një funksion të qenësishëm. Besoj që të shikohet niveli i Qarkut si niveli i parë i qeverisjes, pastaj të vihen njësitet edhe njësitet e vogla, të cilat mund të kenë mungesë kapacitetesh, të delegojnë një kompetencë te Qarku. Ndërsa njësitet, ne duhet t'u kushtojmë rëndësi edhe pjesëmarrjes së tyre, sidomos në vendimmarrje, në Këshillin Bashkiak. E thashë edhe në fjalën time të parë që duhet që anëtarët e Këshillit të jenë nga çdo njësi. Ndodh shumë herë që bashkë pjesë e partive të bie listën edhe lista është emërore. Duhet të jetë listë përfshirëse e gjithë pjesës tjetër që janë për njësitet, duke rritur shqetësimet që ka komuniteti. Ne, gjatë punës tonë, e kemi parë që njësitet administrative, të cilat janë më lart, siç kemi ne thashë Stravën dhe dy fshatra të tjerë, ne e kemi zgjidhur në një formë, duke çuar më shumë punë shërbimesh pranë saj njësie. Administratori, ndihma ekonomike, specialistët e tokave janë aty dhe fshatrat e tjerë që janë përbërësi i asaj bashkisë, i mbulon Drejtorja e Shërbimeve apo të gjithë funksionet e tjera që ne kemi. Atë që tha deputeti Mziu, mbi lehtësim, duke parë dhe duke ndjekur punën që ka qenë vetë kryetar bashkie, një kryetar bashkie në territor gjithmonë nuk është i kënaqur me çfarë kompetencash ka, pasi shikojmë që gjatë punës dalin edhe funksione të tjera që duan

mbështetje. Po, unë besoj që reformën e 2014-s duhet disa kompetenca të na kthehen për sa i përket... Ne kemi edhe në territor, na marrin telefon edhe për një qendër shëndetësore, e cila nuk është infermieri aty. Ai zvarret nga ne. Duhet që sistemi parësor të jetë në bashki apo edhe disa funksione të tjera, të cilat do të jenë më afër qytetarëve. Qytetarët do marrin shërbime më të mira gjithmonë, edhe falë përkushtimit, por edhe mbështetjes që do të ketë nga ana e qeverisë apo e bashkive.

Luçiano Boçi:

Po, zoti Maçi!

Bukurosh Maçi:

Në lidhje me kompetencat e administratorëve apo të njëjësive, unë mendoj që janë ato kompetenca dhe mirëfunksionimi i gjithë halkave të bashkisë e bën të lehtë edhe për një administrator dhe pa ndarje territoresh: është kjo njësi apo është bashkia? Për mua janë të gjitha njësoj. Ndërsa, në lidhje me fjalimin e gjatë të deputetit, unë... Komisioni do t'i shikojë disa kompetenca të bashkive, sepse janë disa elementë që ndikojnë në punën dhe në vazhdimësinë e punëve të bashkive, por ne i thamë, por unë vazhdoj dhe mendoj që gjithçka, mirëfunksionimi i një bashkie varet shumë nga kryetari, stafi dhe përkushtimi i tij në shërbim të qytetarëve. Faleminderit!

Luçiano Boçi:

Po, zoti Tafani, fjala për ju!

Arif Tafani:

Në lidhje me kompetencat për t'u pasur parasysh nga Komisioni për reformën e re, do të thoja që, sido ta organizosh njësinë administrative, atë do ta emërojë kryetari, kështu që nuk besoj, por për mua, Këshilli i Qarkut ka dalë nga roli në Kushtetutë dhe në ligj nga viti 2000, nuk kryen më atë rol koordinues ndërmjet njëjësive, pothuajse është inekzistent dhe do provozoja që të shihet organizimi i këtij pushteti dytësor. Do të thoja që bashkitë sot kanë mangësi dhe duhet riparë, sepse janë deleguar funksione, por të pambështetura mirë financiarisht. Patjetër dhe këtu jap përgjigje zotit Mziu që duhet riparë granti në përqindje të GDP-së për pushtetin vendor. Është rritur vitet e fundit, por mendoj se ka nevojë. Dhe po ashtu, duhet që pushteti vendor të marrë rentën minerare dhe të gjitha asetet, të gjitha pasuritë publike që janë në territor, duhet të menaxhohen nga pushteti vendor. Pra, Tirana, ngadalë, avash-avash, duhet të lëshojë kompetenca drejt njëjësive vendore. Këtu do bëja një saktësim: asnjë nga kolegët në të pranishëm sot nuk thanë që është ulur fondi i pagave dhe i sigurimeve shoqërore. Ne thamë është ulur numri i punonjësve. Rritja e fondit në total vjen si rezultat i rritjes së pagave. Paga minimale ka qenë 30 mijë lekë në 2015-ën, ka shkuar 50 mijë lekë dhe para dy vitesh, në 2024, mos harroni që ka pasur një rritje deri në 130% të pagave të nëpunësve dhe specialistëve dhe ai fondi që zoti Mziu përmend që është rritur në total si shifër, ka ardhur jo për shkak të rritjes së numrit, por mendoj unë për shkak të rritjes së pagave. Faleminderit!

Luçiano Boçi:

Po, zoti Disha!

Mariglen Disha:

Për sa i përket kompetencave të njësive administrative, Bashkia e Librazhdit i ka kaluar me urdhër të mbrëmshëm kompetencat për sa i përket rikonstruksioneve, rrethimeve, sistemimeve të jashtme, të objekteve të njësive administrative që janë në territorin e njësive administrative, e kanë kompetencë administratorët. Për sa i përket rrugëve, punëve publike, ndriçimit, janë persona që janë banorë të fshatrave të zonave dhe varen nga Drejtoria e Përkatëse e Bashkisë së Librazhdit, por janë të asaj zone që një problem, një defekt që kanë, janë direkt banorët e zonës që shkojnë dhe kryejnë shërbimin e duhur. Faleminderit!

Luciano Boci:

Zoti Doka!

Florenc Doka:

Është patjetër që është shumë e nevojshme dhe do të ishte absurde që një kryetar bashkie të mos donte më shumë kompetenca. Kompetencat patjetër që ato të caktuara në ligjin 139, por edhe kompetenca të tjera që të bashkive në bazë të parimit të decentralizimit do duhet t'i shtoheshin. Se si bashkitë pastaj do ta përkthejnë këtë gjë me punën apo me zbatimin e këtyre kompetencave, kjo është një gjë që duhet ta vendosi, besoj, ky komision, se sa të afta dhe sa mundësi reale kanë për t'i ushtruar këto kompetenca, por... Për sa i përket... Po, thashë për atë të zotit Mziu, për sa i përket njësive administrative, sa më shumë të rrisnin bashkive, për kryetarët e bashkive, kompetencat dhe delegimi i atyre për njësitë është ai i nevojshëm, sepse rrjedh siç është edhe sot ato që kemi, delegohet edhe njësive. Sa më shumë të rriten kompetencat, aq më shumë kompetenca duhet të kenë dhe njësitë administrative.

Luçiano Boçi:

Atëherë, zoti Mziu dhe zonja Koçehu, për një koment...

Xhelal Mziu:

Vetëm një koment të shkurtër. Secilin prej jush të pesëve, ju sfidoj që jo vetëm që është rritur, por është rritur edhe më herë numri i punonjësve nga viti 2015 deri ditën e sotme. Pra, nuk është indikator vetëm rritja e nivelit të pagës, por indikator kryesor ngelet ndonjëherë rritja e numrit të punësuarve. Kanë qenë diku te 17 mijë e ca, ka shkuar tani mbi 40 mijë të punësuar. Pra, çfarë do të thotë që në çdo njësi vendore është rritur numri i të punësuarve, krahas rritjes së nivelit të pagës.

Luçiano Boçi:

Po, atëherë, zonja Koçeku, keni një koment?

Marjana Koçeku:

Një koment të vogël. Në fakt, pyetja që u bë ishte edhe si deputete, por edhe si banore e një njësie të vogël periferike të bashkisë Shkodër dhe këtu duke marrë parasysh se shpeshherë për shkak të largësive dhe arsyeve të tjera, shpesh ndodh një... shpesh në rang kombëtar, duke marrë parasysh edhe dëgjesat që kena bërë dhe opinionin nga komuniteti dhe banorët, ndodh që të ketë një pabarazi dhe pavëmendje shpesh në mënyrën se si shpërndahen investimet publike dhe të mira të tjera. Pra, nga kjo mora shkak që e bëra edhe pyetjen, por kryetari të përgjigjet dhe i falenderoj.

Luçiano Boçi:

Po, atëherë... atëherë përfundojmë këtu dëgjuesën me kryetarët e bashkive të Qarkut Elbasan dhe vijojmë në ora 14:00 me Qarkun e Kukësit. Po, faleminderit!

Arbjan Mazniku:

Kryetar, shumë faleminderit edhe nga ana ime për gjithë gjënë. Do mbetemi në vijimsi në kontakt.